

**STUDIM**

**MBI VLERËSIMIN E MEKANIZMIT TË KËRKESË-ANKESËS  
NË INSTITUCIONET E PRIVIMIT TË LIRISË NË SHQIPËRI**

---

**Tiranë, Shtator 2011**

Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Për një respektim më të mirë të personave të privuar nga liria në institucionet e mbyllura” zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga OSI Budapest.



KOMITETI SHQIPTAR I  
HELSINKIT



Ky publikim është botuar me mbështetjen e OSI Budapest. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e ekspertëve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e OSI Budapest.

Ekspertët: Dr. Migena Leskoviku & M.A. Cand. Mag. Edlira Papavangjeli

Përgatiti për botim: M.A. Klejda Ngjela

Nëse jeni të interesuar për këtë manual, mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. “Gjin Bue Shpata”,  
Pall. 5/1, Ap. 4, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 04 233671  
E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al);  
[www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesit.

Botues: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

## **Tabela e Lëndës**

### **Hyrje**

#### **I. Inspektimet dhe monitorimet në institucionet e privimit të lirisë**

- 1.1. Përkufizimi i termave/koncepteve kyçe
- 1.2. Nevoja për një mekanizëm efektiv të ankesave dhe monitorimi i tyre
- 1.3. Qëllimi dhe metodologjia e studimit
  - 1.3.1 Qëllimi i këtij studimi
  - 1.3.2 Metodologjia e përdorur

#### **II. Standardet ndërkombëtare: rëndësia e krijimit të strukturave përgjegjëse**

- 2.1 Standardet evropiane
- 2.2 Standardet ndërkombëtare
- 2.3 Krijimi i strukturave të jashtme të pavarura
  - 2.3.1 Strukturat evropiane dhe ndërkombëtare të monitorimit
- 2.4 Modelet evropiane në lidhje me strukturat e brendshme të llogaridhënies dhe aspektet organizative të tyre
  - 2.4.1 Situata në Holandë
  - 2.4.2 Situata në Angli dhe Wells

#### **III. E drejta e kërkesës dhe e ankimit: legjislacioni shqiptar në këndvështrimin e standardeve ndërkombëtare**

- 3.1 Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar nga policia
  - 3.1.1 Të drejtat që u njihen personave të shoqëruar në polici
  - 3.1.2 Të drejtat që u njihen personave të ndaluar/arrestuar
  - 3.1.3 Mekanizmat e brendshëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave në policinë e shtetit
  - 3.1.4. Mekanizmat e jashtëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave në policinë e shtetit
- 3.2. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e privuar nga liria në paraburgime dhe burgje
  - 3.2.1. Të drejtat që u njihen personave të privuar nga liria në burgje dhe paraburgime
  - 3.2.2. Mekanizmat e brendshëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të personave të privuar nga liria në burgje dhe paraburgime
    - 3.2.2.1. Inspektori për Çështjet Ligjore dhe të Sigurisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
  - 3.2.3. Mekanizmat e jashtëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të personave të privuar nga liria në burgje dhe paraburgime
    - 3.2.3.1. Prokurori i ngarkuar me mbikëqyrjen në ekzekutim

- 3.2.3.2. Komisioni mbikëqyrës i ekzekutimit të dënimeve me burgim kompetente.
- 3.2.3.3. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) pranë Avokatit të Popullit
- 3.2.3.4. Gjykata
- 3.2.3.5. Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare

#### **IV. Gjetjet dhe problematika që lidhet me zbatimin praktik të mekanizmit të kërkesë-ankesës**

- 4.1. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar nga policia
  - 4.1.1. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e shoqëruar nga policia
  - 4.1.2. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e ndaluar/arrestuar nga policia
  - 4.1.3. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e privuar nga liria në paraburgime dhe burgje
  - 4.1.4. Kontrolli/monitorimi i brendshëm
  - 4.1.5. Kontrolli/monitorimi i jashtëm
  - 4.1.5/a Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare

#### **V. Sugjerime**

- 5.1. Për përmirësimin e bazës ligjore
- 5.2 Për përmirësimin e zbatimit të ligjit
- 5.3 Për rritjen e efikasitetit të strukturave mbikëqyrëse/inspektuese/monitoruese të brendshme/të jashtme

#### **Bibliografia dhe Anekset**

- Bibliografia
- Lista e personave të kontaktuar në institucionet e vizituara
- Të dhëna statistikore

## Hyrje

Monitorimi dhe inspektimi i vendeve të privimit të lirisë, si dhe krijimi i një mekanizmi të pavarur të brendshëm dhe të jashtëm për shqyrtimin e ankesave të personave të privuar nga liria, janë themelore për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe janë pjesë e detyrimeve të Shqipërisë sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Monitorimi përfshin në vetvete monitorimin e brendshëm nëpërmjet shërbimeve që e mundësojnë posaçërisht një gjë të tillë, apo nëpërmjet monitorimit të jashtëm që sipas rastit mund të kryhet përmes kontrollit gjyqësor nga gjyqtarë apo prokurorë, organe monitoruese zyrtare që janë të pavarura në aktivitetin e tyre monitorues, OJF dhe media. Monitorimi ndihmon që të jepet një panoramë e qartë e situatës së brendshme në një vend, si dhe masat që duhen marrë me qëllim garantimin praktik dhe ligjor të masave të nevojshme për respektimin e të drejtave dhe lirive të personave të privuar nga liria në këto institucione. Prandaj, monitorimi konsiderohet një element esencial në procesin dinamik të ngritjes dhe funksionimit të një sistemi mbrojtës për personat e privuar nga liria.

Funksioni kryesor i pothuajse të gjitha organeve të mbikëqyrjes të jashtme dhe të brendshme të vendeve të privimit të lirisë në Shqipëri ka qenë trajtimi i ankesave, të cilat, gjatë viteve, janë rritur në numër dhe, pa dyshim kanë ndikuar edhe në sensibilizimin e institucioneve përgjegjëse për garantimin e këtyre të drejtave për personat e privuar nga liria. Megjithatë, ka patur pak kërtime në studimin e efektivitetit në shqyrtimin e kërkesave/ankesave në vendet e privimit të lirisë, si dhe përpjekje të kufizuara për përmirësimin e procedurave dhe sistemit ekzistues të ankesave.

Për të realizuar këtë studim, ekspertët e përfshirë kanë përdorur një ndërthurje të burimeve parësore dhe dytësore. Burimet parësore të tilla si: të dhënat zyrtare për këtë çështje, intervistat me personelin e komisarivateve të policisë dhe të institucioneve penale, si dhe intervistat me personat e privuar nga liria janë konsultuar dhe sjellë në këtë studim. Burimet dytësore si literatura vendase dhe e huaj në këtë fushë, si dhe konsultimi dhe studimi i bazës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare përbën bazën e qasjes teorike të studimit.

Duke pasur parasysh praktikën e zhvilluar ndërkombëtar në këtë drejtim, në këtë studim i kemi kushtuar, jo pa qëllim, rëndësi njohjes dhe prezantimit të standardeve dhe rregullave që aktet ndërkombëtare parashikojnë për të garantuar një trajtim të përshtatshëm të kërkesave/ankesave të personave të privuar nga liria. Vëmendje e veçantë në këtë pjesë të studimit i është kushtuar Rregullave Evropiane të Burgjeve si dhe disa modeleve perëndimore që mund të shihen si shembull i mirë për t'iu referuar dhe përshtatur për sistemin shqiptar të policisë dhe burgjeve.

Me rëndësi sa teorike, aq edhe praktike është pjesa e analizës së legjisllacionit të brendshëm në fuqi, garancive që ai ofron si dhe boshllëqeve që kërkojnë ndërhyrje dhe përmirësim të tij me qëllim vendosjen e një mekanizmi efektiv të kërkesë/ankesës në institucionet e privimit të lirisë dhe zbatimin e tij praktik. Kjo pjesë e studimit ndiqet nga trajtimi i mekanizmave ekzistues të kërkesë/ankesës, qofshin këta të brendshëm apo të jashtëm, duke u ndalur në efikasitetin e tyre, me

qëllim garantimin e të drejtës së personave të privuar nga liria për të pasur akses në një mekanizëm (të brendshëm apo të jashtëm) të drejtë/të rregullt dhe efektiv të trajtimit të tyre.

Ky studim, ndoshta i vetmi deri më tani i këtij lloji me këtë tematikë të rëndësishme, me gjetjet e tij, mbyllet me disa rekomandime të rëndësishme që i sugjerojnë autoriteteve vendase në përmirësimin e aspektit ligjor dhe institucional të vendosjes dhe zbatimit praktik të këtij mekanizmi të kërkesë/ankesës.

KShH dhe ekspertët e tij gjejnë rastin të falënderojmë autoritetet shtetërore si Ministrinë e Drejtësisë (MD), Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB), Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) dhe drejtuesit e komisariateve të policisë dhe të institucioneve penale të cilët mirëpritën këtë studim dhe bënë të mundur vizitat në institucionet përkatëse. Pa bashkëpunimin me autoritetet përkatëse, ky studim nuk do të bëhej i mundur.

KShH shpreson që ky studim të shërbejë si pikë nisje e një analize të plotë dhe më pas të çojë në marrjen e masave përkatëse për përmirësimin e funksionimit të mekanizmit të kërkesë-ankesës.

## I. Përkufizimi i termave/koncepteve kyç

**1.1** Për efekt të këtij studimi, vlen të japim disa koncepte kyçe që i hasim gjerësisht në studim për të kuptuar më mirë terminologjinë e tij. Këto terma burojnë nga standardet ndërkombëtare në fushë dhe janë huazuar e janë bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm.

### Privimi i lirisë

Privimi i lirisë nënkupton çdo formë të ndalimit ose burgimit apo vendosjen e një personi në një ambient privues publik apo privat, nga i cili ky person nuk lejohet të largohet sipas dëshirës së tij<sup>1</sup>. Kjo bëhet vetëm me urdhër të një autoriteti gjyqësor, administrativ apo të ndonjë autoriteti tjetër publik<sup>2</sup>.

Ndonëse ky përkufizim është i përgjithshëm për çdo formë të privimit të lirisë, për qëllime të studimit, ne do t'i referohemi privimit të lirisë, që jepet nga një autoritet gjyqësor kompetent në përputhje me legjislacionin tonë. Në linjë me përcaktimet ndërkombëtare është edhe rregullimi që bën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila përcakton se: *“Askujt nuk mund t'i hiqet liria përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.*

*Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për*

<sup>1</sup> Rregulla 11.b - Rregullat e OKB për Mbrojtjen e Fëmijëve të Privuar nga Liria (ndryshe njihen si Rregullat e Havanës), 1990

<sup>2</sup> Ndonëse Rregullat e Havanës i dedikohen të miturve, ky përkufizim i privimit të lirisë vlen si koncept edhe për të rriturit.

*shoqërinë; për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit*<sup>3</sup>.

## **Paraburgimi**

Lidhet me periudhën kur personat janë të privuar nga liria, dhe përfshin periudhën ndërmjet momentit kur ngrihet akuza dhe dhënies së vendimit përfundimtar të gjykatës<sup>4</sup>. Në Rregullat Standarde Minimale të OKB, në pikën 84.1 të saj jepet ky përcaktim: *‘Personat e arrestuar ndaj të cilëve rëndon një akuzë penale, që mbahen në polici apo në paraburgim por që ende nuk janë gjykuar dhe dënuar, do të konsiderohen si persona të paraburgosur*<sup>5</sup>. Të paraburgosurit duhet të konsiderohen të pafajshëm deri në vendimin përfundimtar të gjykatës dhe për pasojë, duhet të trajtohen si të tillë.

Po ashtu, në linjë dhe në përputhje të plotë me Rregullat Standarde Minimale të OKB, të njëjtin qëndrim për paraburgimin mban edhe Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve Rec (2006)2, miratuar në Janar 2006, që përcaktojnë se: *“Për qëllim të këtyre rregullave, personat e paraburgosur janë ata të cilët janë mbajtur në paraburgim me vendim të një autoriteti gjyqësor para sesa të gjykohen dhe dënohen me vendim të formës së prerë”*<sup>6</sup>.

## **Burgimi**

Ndodh kur një personi i kufizohet liria e lëvizjes, pasi mbahet në një vend ku nuk lejohet të largohet prej tij me vullnetin e tij/saj të lirë<sup>7</sup>, ku privimi i lirisë bëhet si rezultat i dënimit nga gjykata për shkak të kryerjes së një vepre penale. Burgimi duhet të jepet vetëm nga autoriteti kompetent i përcaktuar me ligj, i cili është gjykata.

Si në rastin e paraburgimit ashtu edhe të burgimit, të gjithë personat duhet të trajtohen në mënyrë humane dhe me respekt për integritetin e tyre të brendshëm si qenie njerëzore. Arresti, paraburgimi apo burgimi duhet të bëhen në mënyrë strikte në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe vetëm nga autoritetet kompetente që ligja autorizon<sup>8</sup>.

## **Monitorimi dhe Inspektimi**

Kontrolli në vendet e privimit të lirisë përfshin monitorimin dhe inspektimin. Inspektimi në këto institucione nënkupton një veprimtari e cila realizohet si pjesë e funksionit burokratik dhe operativ të

<sup>3</sup> Shih paragrafin 1 dhe 2 të nenit 27 të Kushtetutës së RSH.

<sup>4</sup> Grupi i Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave që i nënshtrohen çdo forme burgimi apo paraburgimi, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, dhjetor 1988.

<sup>5</sup> Termi origjinal i përdorur në anglisht në këto Rregulla është “untried prisoners”.

<sup>6</sup> Rregulli 94.1 i Rregullave Evropiane të Burgjeve, Rec (2006)2

<sup>7</sup> Grupi i Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave që i nënshtrohen çdo forme burgimi apo paraburgimi, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, dhjetor 1988.

<sup>8</sup> Parimi 1 dhe 2 - Grupi i Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave që i nënshtrohen çdo forme burgimi apo paraburgimi, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, dhjetor 1988.

sistemit të policisë dhe burgjeve dhe këto veprimtari ndërmerren nga vetë strukturat përkatëse shtetërore<sup>9</sup>.

Ndërsa e kundërta kuptohet me monitorimet, të cilat janë veprimtari kontrolluese që ndërmerren nga organe/struktura/organizata të pavarura nga funksionimi i sistemit të policisë dhe burgjeve. Në veprën e tij Van Zyl Smit dhe Snachen<sup>10</sup> bën dallimin mes inspektimeve të brendshme qeveritare dhe monitorimeve të pavarura kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Në këtë veper theksohet se pavarësia e siguruar gjatë monitorimeve dhe inspektimeve ashtu siç sanksionohet në Rekomandimin Rec(2006)2 të Këshillit të Ministrave për vendet anëtare për Rregullat Evropiane të Burgjeve është ajo që ka më shumë rëndësi dhe jo aq shumë terminologjia<sup>11</sup>.

Inspektimet janë të brendshme kur ato realizohet brenda sistemit të policisë dhe burgjeve, ndërsa e jashtme realizohen nga struktura jashtë sistemit të policisë dhe burgjeve siç janë gjykatat, prokuroria, Avokati i Popullit, OJF-të që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe në statutin e tyre e kanë të përcaktuar veprimtarinë monitoruese në këtë fushë, si edhe struktura të pavarura mbikëqyrëse siç janë Bordet/Komisionet Mbikëqyrëse.

## **1.2 Nevoja për një mekanizëm efektiv të ankesave dhe monitorimi i tyre**

Monitorimi i trajtimit dhe kushteve infrastrukturore/fizike të privimit të lirisë të personave të privuar nga liria përmes vizitave të rregullta, është një nga mjetet më efektive për të vëzhguar respektimin e të drejtave të njeriut në këto ambiente.

Mbikëqyrja dhe inspektimi i vendeve të privimit të lirisë me mekanizmat e brendshëm është një angazhim dhe përgjegjësi e plotë dhe ligjore që agjencitë qeveritare për zbatimin e ligjit kanë për të garantuar dhe demonstruar ndaj personave të privuar nga liria nën kujdesin e tyre. Organi(et) i mbikëqyrjes së brendshme është/janë krijuar për të siguruar (në emër të shoqërisë) që të dënuarit të marrin trajtim korrekt. Ata kanë një rol ndërmjetës në mes të dënuarve dhe institucioneve penale. Këto organe mund të ofrojnë këshillime ligjore për Ministrinë e Drejtësisë (MD) mbi reformimin e sistemit penitenciar dhe të drejtësisë për të mitur dhe mund të marrin ankesat e të dënuarve. Detyrat kryesore të organeve të brendshme të inspektimit lidhen me inspektimin në zbatimin e sanksioneve dhe në veçanti në lidhje me "trajtimin" dhe "sigurinë". Është e nevojshme që protokollet e shkruara të kenë të përcaktuara kompetenca të qarta të mbikëqyrjes së brendshme dhe të organeve të inspektimit në mënyrë që të shmangin mbivendosjen dhe për të siguruar komplimentaritetin efektiv të këtyre organeve, transparencën, profesionalizmin dhe objektivitetin e mbikëqyrjes së tyre dhe punën e inspektimit të kryer prej këtyre organeve.

Ideja e monitorimit të jashtëm dhe të pavarur të vendeve të privimit të lirisë (përveç mbikëqyrjes së brendshme dhe mekanizmave të inspektimit) ka bërë përparim të konsiderueshëm gjatë viteve të fundit. Tashmë pranohet gjerësisht se monitorimi i jashtëm dhe i pavarur është një nga masat

---

<sup>9</sup> Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 92.

<sup>10</sup> D. van Zyl smit – S. Snachen: Parimet e së Drejtës Evropiane të Burgjeve dhe Politikave, Oxford: Oxford University Press, 2009, p.116.

<sup>11</sup> Ankesat – Vlerësimi i Mekanizmave të ankesës në burgje në Evropën Lindore Qendrore – Komiteti Hungarez i Helsinkit në bashkëpunim me OSI, Budapest 2010



mbrojtëse më të mira kundër çdo shkelje të ligjit për vendet e privimit të lirisë. Ndaj dhe vendet e privimit të lirisë duhet të jetë sa më transparente të jetë e mundur, duke mundësuar akses për strukturat/organet/organizmat jashtë policisë / sistemit të burgjeve.

Mbikëqyrja apo inspektimi i brendshëm dhe i jashtëm si dhe mekanizmat monitorues synojnë parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe trajtimin e personave të privuar nga liria. Për të përmbushur qëllimin e tyre ato zhvillojnë vizita reaguese dhe proaktive. Vizitat reaguese bëhen për mbikëqyrjen e një individi të veçantë. Në këtë rast metodologjia e vizitës ndërtohet për të siguruar mundësinë që ka të bëjë me trajtimin e një çështjeje individuale. Vizitat janë të një natyre më shumë ad hoc<sup>12</sup>. Zakonisht ato kryhen në përgjigje të një ankese të marrë në mënyrë individuale ose kolektive.

Vizitat proaktive, nga ana tjetër, në vend që të merren me raste të veçanta në mënyrë të drejtpërdrejtë, kanë për qëllim të adresojnë problemet më të përgjithshme dhe sistematike të qenësishme brenda sistemit. Ato janë menduar për të parë zbatimin e përgjithshëm të politikës së burgut. Në kontrast me vizitat reaguese, të cilat ofrojnë një mundësi për të trajtuar një shkelje që ka ndodhur, vizitat proaktive përqendrohen në mundësinë potenciale, për të siguruar që një shkelje të mos ndodhë në të ardhmen. Këto lloj vizitash monitoruese duhet të përqendrohen në shkeljet e mundshme të ligjeve, rregullave dhe rregulloreve në përgjithësi, si zbatimi i programeve të përditshme, qëndrimet dhe sjelljet e stafit, mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve, etj. Për pasojë, parimet mbi të cilat bazohen vizitat proaktive, janë angazhime afat-gjata me autoritetet publike dhe me dialogun konstruktiv, në vazhdimësi, por edhe me konfidencialitetin, në mënyrë që të sigurohet një ndryshim gradual në "kulturën" e sistemit të drejtësisë penale, duke siguruar mbrojtjen e individit të privuar nga liria në kujdesin e këtij sistemi. Megjithatë, të dy llojet e vizitave janë komplementare/bashkëplotësuese.

Si mbikëqyrja apo inspektimi i brendshëm dhe i jashtëm ashtu edhe mekanizmat monitorues janë të nevojshëm për të siguruar mbikëqyrjen efektive dhe transparente të të drejtave dhe trajtimin e personave të privuar nga liria.

Protokollet ligjore të shkruara të cilat përfshijnë qëllimin, metodologjinë e punës dhe fushëveprimin e punës së këtyre strukturave të monitorimit dhe mbikëqyrjes/inspektimit e bën veprimtarinë e tyre transparente dhe të besueshme.

### **1.3 Qëllimi dhe metodologjia e studimit**

#### **1.3.1 Qëllimi i këtij studimi**

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë kuadrin e brendshëm ligjor mbi mekanizmat e ankimit në vend për individë të privuar nga liria dhe të zbatimit të tij praktik në mënyrë që të identifikohen mangësitë dhe problemet që dalin nga praktika. Bazuar mbi këto gjetje janë formuluar rekomandime për përmirësimin e legjislacionit të brendshëm dhe zbatimin e tij praktik në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.

---

<sup>12</sup> Për rast specifik.

Funksioni kryesor i pothuajse të gjitha organeve të mbikëqyrjes të jashtme dhe të brendshme të vendeve të privimit të lirisë në Shqipëri ka qenë hetimi i ankesave, të cilat, gjatë viteve, janë rritur në numër dhe, pa dyshim kanë ndikuar në gatishmërinë dhe aftësinë e këtyre organeve për të kryer vizita proaktive. Megjithatë, ka patur pak kërkime në studimin e efektivitetit të organeve të ankesave në shqyrtimin e ankesave në vendet e privimit të lirisë dhe përpjekje të kufizuara për përmirësimin e procedurave dhe sistemit ekzistues të ankesave.

Personat e privuar nga liria mund të ankohen paralelisht në administratën e institucionit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB), MD, Komisionin e Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim (KMVEB), Zyrën e Avokatit të Popullit (AP), zyrën e prokurorit, gjykatë, autoritetet lokale, OJF-të, organizatat ndërkombëtare, etj.. Ekspertët kanë tërhequr vëmendjen edhe për problemin e shqyrtimit në kohën e duhur dhe me efektivitet të ankesave të personave të privuar nga liria, pasi ankesat janë dërguar shpesh nga një organizatë në një tjetër, dhe, në mungesë të përcjelljes së informacionit, organet që merren me ankesat mbeten shpesh të painformuar në lidhje me vendimet dhe masat e marra nga organet e tjera.

Ka mungesë në analizën e rregullt të ankesave brenda organeve të ankesave, dhe mungesë të bashkëpunimit të rregullt mes tyre, gjë e cila do të kontribuonte në zgjidhjen e problemeve kyçe në këtë drejtim. Shumë ankesa lindin nga mungesa e interpretimit uniform të dispozitave ligjore nga administrata e institucioneve të privimit të lirisë dhe nga mungesa e informacionit për legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ndërsa pranohet se shumica e ankesave mund të zgjidhen brenda institucionit, nuk janë të rrallë rastet, kur personat e privuar nga liria nuk kanë besim në sistemin e brendshëm të ankesave. Për më tepër, nuk ka një sistem transparent se cilat janë organet e inspektimit dhe monitorimit dhe të mbikëqyrjes, cilat janë kompetencat e tyre, qëllimi dhe metodologjia e punës dhe se si ata bashkëpunojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin.

Është e nevojshme një reformë e sistemit të menaxhimit të ankesave të personave të privuar nga liria për të kapërcyer problemet që lidhen me këtë sistem që do të çonte në ndryshime në procedurën e shqyrtimit të ankesave, analizën e rregullt të tyre brenda organeve të trajtimit të ankesave, si dhe do të lehtësonte bashkëpunimin intensiv mes tyre. Procedurat e ankesave dhe rrugët që ndiqen në të tjera sisteme burgjesh, do të meritojnë vëmendje të mëtejshme.

Po ashtu, vëmendje meritojnë edhe ankesat në lidhje me trajtimin që i bën administrata e policisë individëve të shoqëruar/arrestuar/ndaluar. Disa organe kanë kompetenca për të shqyrtuar ankesat individuale për shkelje të kryera nga policia. Ankesat mund t'i drejtohen organeve të brendshme mbikëqyrëse, të cilat raportojnë tek Ministri i Brendshëm. Kritika janë shprehur nga organizata vendase dhe të huaja për sa i përket pavarësisë, transparencës dhe profesionalizmit të tyre.

Kur personat janë në komisariatet e policisë nuk ka pothuajse asnjë të dhënë zyrtare lidhur me ankesat që këta persona mund të kenë për mënyrën sesi respektohen të drejtat e tyre nga personeli i këtyre institucioneve dhe për mënyrën sesi trajtohen ata. Ky është një tregues i mungesës së njohurive të personave në konflikt me ligjin për të drejtën e tyre të ankimit, por edhe të mungesës së informimit të tyre lidhur me këtë të drejtë. Siç do të shihet edhe gjatë analizës, ka mungesë të bazës së qartë ligjore për procedurat e kërkesë-ankesës në komisariatet e policisë.

Duke thënë këtë, ky studim do të sigurojë analizë, si të aspekteve ligjore ashtu dhe aspekte të zbatimit të legjislacionit në lidhje me mekanizmin e ankesës.

### 1.3.2 Metodologjia

Për efekt të realizimit të këtij studimi, metodologjia e zbatuar bazohet në vizitat në institucionet e privimit të lirisë, në intervistat me personelin e këtyre institucioneve dhe personat e privuar nga liria që ndodheshin në to në momentin e vizitave në terren, statistikave dhe të dhënave të mbledhura në këto institucione apo nga institucione të tjera që merren ose që i monitorojnë këto institucione, si dhe publikime të ndryshme për këtë qëllim<sup>13</sup>. Të dhënat janë paraqitur si aneks në fund të studimit. Ajo që duhet theksuar është se nuk ka të dhëna të përgjithshme zyrtare për kërkesë/ankesat e bëra nga ana e personave të privuar nga liria në këto institucione të monitoruara. Të dhënat mbi kërkesat/ankesat e pasqyruara në këtë studim i përkasin të dhënave të marra në institucione të veçanta, objekt monitorimi.

Gjithashtu, të dhëna që lidhen me objektin e studimit e që disponohen nga KSHH-ja gjatë vizitave të saj monitoruese të kryera në vazhdimësi, janë bërë pjesë e këtij studimi në pjesë të veçanta të tij. Në studim gjen vend të rëndësishëm pasqyrimi i akteve ndërkombëtare në këtë fushë si dhe bëhet një analizë e plotë e legjislacionit shqiptar në fuqi në lidhje me mekanizmin e kërkesë-ankesë për personat e privuar nga liria, duke analizuar ndër të tjera edhe zbatimin praktik të tij si dhe nevojën për ndryshime apo përmirësim në kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi në respekt të garantimit të të drejtave dhe lirive të personave të privuar nga liria.

## II. Standardet ndërkombëtare: rëndësia e krijimit të strukturave përgjegjëse

### 2.1. Standardet Evropiane

Rregullat Evropiane të Burgjeve

#### *Kërkesat dhe ankesat*

Rregulli 70.1 *Të burgosurit, individualisht ose si grup, duhet të kenë mundësi të mjaftueshme për të bërë kërkesa apo ankesa drejtuar drejtorit të burgut ose ndonjë autoriteti tjetër kompetent.*

Rregulli 70.2 *Nëse ndërmjetësimi duket i përshtatshëm, atëherë ky duhet të jepet së pari.*

Rregulli 70.3 *Nëse një kërkesë mohohet ose një ankesë refuzohet, të dënuarit duhet t'i ofrohen arsye dhe i dënuari do të ketë të drejtë të ankohet pranë një autoriteti të pavarur.*

---

<sup>13</sup> Këtu janë përfshirë ndër të tjera të dhëna të Avokatit të Popullit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Rregulla 70.4 *Të burgosurit nuk duhet të dënohen për shkak se kanë bërë një kërkesë ose depozituar një ankesë.*

Rregulla 70.5 *Autoriteti kompetent duhet të marrë parasysh çdo ankesë me shkrim nga të afërmit e një të burgosuri kur ata kanë arsye për të besuar se të drejtat e të burgosurit janë shkelur.*

Rregulla 70.6 *Asnjë ankesë nga një përfaqësues ligjor ose organizatë që merret me mirëqenien e të burgosurve nuk mund të sillet në emër të një të burgosuri, nëse i burgosuri në fjalë nuk jep pëlqimin për të.*

Rregulla 70.7 *Të burgosurit kanë të drejtë të kërkojnë këshilla ligjore rreth procedurave të ankesave dhe apelimeve dhe të ndihmës juridike kur e kërkojnë interesat e drejtësisë.*

## **2.2. Standardet Ndërkombëtare**

Në nenin 36 të Rregullave Standarde Minimale të OKB për Trajtimin e të Burgosurve ka një dispozitë të veçantë për të bërë një ankesë, gjatë një inspektimi në burg. Ky nen parashikon:

*Rregulla 3.2 Duhet të bëhet e mundur të bëhen kërkesa ose ankesa drejtuar inspektorit të burgjeve gjatë inspektimit të tij. I dënuari duhet të ketë mundësi për të biseduar me inspektorin, ose me çdo zyrtar tjetër inspektimi pa drejtorin apo anëtarë të tjerë të stafit.*

## **2.3 Krijimi i strukturave të jashtme të pavarura**

Gjatë disa dekadave të fundit ka pasur zhvillime pozitive lidhur me ngritjen e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, Avokatit të Popullit, organet e specializuara me kompetenca të përgjithshme apo specifike dhe përfshirjen e standardeve ndërkombëtare në institucionet e tilla në nivel botëror dhe rajonal. Në vitin 1993 Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi "Parimet lidhur me Statusin e Institucioneve Kombëtare", të cilat janë të njohur gjerësisht si Parimet e Parisit. Parimet e Parisit në lidhje me listën e kriterëve parashikojnë funksionimin efektiv të një institucioni kombëtar të të drejtave të njeriut, të tilla si pavarësia institucionale dhe funksionale, kompetenca të gjera, fonde të mjaftueshme për funksionimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Raportet e publikuara në këtë drejtim synojnë të ndihmojnë institucionet kombëtare në mënyrë që të përmirësojnë performancën dhe ndikimin e tyre duke përdorur standardet dhe treguesit për të vlerësuar punën e tyre.

Në të njëjtën kohë, ka pasur zhvillime në hartimin e standardeve rajonale që lidhen me kompetenca të ndryshme tematike të organeve përkatëse kombëtare. Duke ratifikuar një numër të traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të tilla si Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)<sup>14</sup>, Konventa e OKB kundër Torturës (CAT) dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR), Shqipëria është e detyruar për të trajtuar të gjithë personat në çdo formë ndalimi apo kufizimi me dinjitet dhe me respekt për të drejtat e tyre

---

<sup>14</sup> Në disa raste janë ruajtur akronimet e gjuhës angleze për arsye se disa nga këto akronime njihen gjerësisht në gjuhën shqipe.

njerëzore. Të gjitha këto instrumente, si dhe e drejta ndërkombëtare zakonore, kërkojnë që vendi të parandalojë efektivisht torturën apo trajtimin çnjerëzor ose degradues apo keqtrajtimet në vendet e ndalimit dhe institucionet penale. Mbrojtja efektive e të drejtave të personave të privuar nga liria në një shtet të pavarur kërkon që strukturat përgjegjëse të ngrihen dhe funksionojnë.

Ratifikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) siguron që viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë të drejtën dhe garancinë për rishikim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Përveç kësaj, me ratifikimin e Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe/ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), ka të drejtë të ushtrojë kontroll në vendet anëtare, i cili në një numër rastesh ka vizituar në Shqipëri, vendet e privimit të lirisë dhe i ka pasqyruar vëzhgimet e bëra dhe rekomandimet në raportet e tij.

Në nivel kombëtar, ratifikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka bërë që dispozitat e KEDNJ-së të jenë drejtpërdrejt të zbatueshme përmes gjykatave shqiptare. Shumë dispozita të KEDNJ-së janë të një rëndësie të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Rëndësia kryesore e inspektimit dhe monitorimit të pavarur për mbikëqyrjen e praktikës në vendet e privimit të lirisë është theksuar në 2006, në Rregullat Evropiane të Burgjeve (REB 2006), dhe një nga parimet themelore mbi të cilat janë të bazuara Rregullat është: "Të gjitha burgjet duhet të jetë subjekt i inspektimit të rregullt të qeverisë dhe i monitorimit të pavarur"<sup>15</sup>.

### **2.3.1 Strukturat Evropiane dhe ndërkombëtare të monitorimit**

*Rregulla 92* e REB përcakton se institucionet e privimit të lirisë duhet të inspektohen rregullisht nga një agjenci qeveritare në mënyrë që të vlerësohet nëse ato administrohen në përputhje me kërkesat e ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe dispozitat e këtyre rregullave.

#### **Parimet ndërkombëtare për një monitorim të pavarur**

*Rregulla 93.1* Kushtet e ndalimit dhe trajtimi i personave të privuar nga liria do të monitorohet nga një organ i pavarur apo organe të tjera të cilët rezultatet e tyre do t'i bëjnë publike.

*Rregulli 93,2* Organe të pavarura të monitorimit duhet të inkurajohen për të bashkëpunuar me ato agjenci ndërkombëtare që kanë të drejtë ligjërish të vizitojnë institucionet e privimit të lirisë. Kjo kërkesë për një inspektim të pavarur buron edhe nga dokumentet ndërkombëtare të cilat përqendrohen në menaxhimin e institucioneve të privimit të lirisë të tilla si Rregullat Standarde Minimale të OKB për Trajtimin e personave të privuar nga liria<sup>16</sup>.

Rregullat Minimale Standarde të OKB për Trajtimin e të dënuarve kërkojnë që të ketë një inspektim të rregullt të institucioneve penale dhe shërbimeve nga inspektorët e kualifikuar dhe me përvojë të emëruar nga një autoritet kompetent<sup>17</sup>. Detyra e tyre do të jetë në mënyrë të

<sup>15</sup> Rregulla 9, REB 2006.

<sup>16</sup> Rregulla 55 e Rregullave Standarde Minimale të OKB për trajtimin e personave të privuar nga liria.

<sup>17</sup> Po aty.

veçantë për të siguruar se këto institucione veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret ekzistuese dhe me qëllim për të qenë konform objektivave të shërbimeve penale dhe korrektuese.

*Rregulla 36.2 Duhet të bëhet e mundur për të bërë kërkesa ose ankesa për inspektorin e burgjeve gjatë inspektimit të tij. Të burgosurit duhet të kenë mundësi për të biseduar me inspektorin, ose ndonjë zyrtar tjetër inspektimi pa qenë të pranishëm drejtori ose anëtarë të tjerë të stafit të institucionit.*

Protokolli opsional i OKB i Konventës kundër Torturës dhe trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose poshtëruese (OPCAT, 2002) thekson:

*Qëllimi i këtij Protokolli është të krijojë një sistem vizitash të rregullta të ndërmarra nga organet e pavarura ndërkombëtare dhe kombëtare në vendet ku njerëzit janë të privuar nga liria e tyre, me qëllim parandalimin e torturës dhe të trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese<sup>18</sup>.*

Çdo Shtet Palë duhet të ngrejë, të caktojë ose të mbajë në nivel kombëtar një ose disa organe për të kryer vizita në vendet e privimit të lirisë për parandalimin e torturës dhe të trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (në tekstin e mëtejme të njohura si mekanizëm kombëtar parandalues – MKP<sup>19</sup>). Përgjegjësia për mbikëqyrjen e rregullt të kushteve të institucioneve të privimit të lirisë dhe gjendjen e personave të privuar nga liria, si dhe menaxhimi i këtyre institucioneve, i takon Qeverisë. Autoritetet kombëtare duhet të sigurojnë se institucionet e privimit të lirisë janë të menaxhuara në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Inspektimi qeveritar i brendshëm nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të siguruar mbikëqyrjen e duhur të pavarur të institucioneve të privimit të lirisë, ashtu siç konsiderohet e pamjaftueshme ekzistenca e një mekanizmi të brendshëm të ankesave.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) thekson se "*ankesa efektive dhe procedurat e inspektimit janë garanci themelore kundër keqtrajtimit në institucionet e privimit të lirisë. Personat e privuar nga liria duhet t'i kenë rrugët të hapura për t'iu drejtuar organeve si brenda dhe jashtë kontekstit të sistemit të burgjeve, duke përfshirë edhe mundësinë që të kenë qasje konfidenciale pranë një autoriteti të përshtatshëm*". KPT-ja i kushton rëndësi të veçantë vizitave të rregullta në çdo burg nga një organ i pavarur ka kompetenca që të dëgjojë (dhe nëse është e nevojshme të marrin masa sipas rastit) ankesat nga të burgosurit dhe të inspektojë "ambientet e institucionit".

Duke marrë parasysh sistemet shumë të ndryshme ligjorë dhe të institucioneve të privimit të lirisë në të gjithë Evropën, standardet nuk përshkruajnë ndonjë model të një monitorimi të pavarur të kushteve të institucionit të privimit të lirisë. Ndërsa në komentën e REB 2006, Avokati i Popullit përmendet si një nga mundësitë monitoruese të institucioneve të privimit të lirisë në dispozicion, "*formate (.....) nuk janë të përjashtuara sa kohë që autoritetet e përfshira janë të pavarur dhe të pajisur mirë për të kryer detyrat e tyre.*"

---

<sup>18</sup> Neni 1 i OPCAT

<sup>19</sup> Neni 3 i OPCAT

Ajo që është gjithashtu e rëndësishme është se organi apo organet kompetente, duhet të bëjnë publike rezultatet e tyre dhe çdo rekomandimi të bërë në menaxhimin e burgjeve, t'i bëhet me dije ministrive përkatëse dhe parlamentit.

### **Protokolli Opsional për Konventën Kundër Torturës (OPCAT)**

KPT-ja ka rekomanduar vazhdimisht ngritjen e mekanizmave aktive të inspektimit kombëtar për lloje të ndryshme të institucioneve të privimit të lirisë dhe ka hartuar disa kriteret për funksionimin efektiv të tyre. Në disa çështje ato nuk janë të detajuara siç janë hartuar kriteret e mekanizmave parandalues kombëtarë siç janë të përshkruara në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së kundër Torturës (OPCAT). OPCAT përcakton standardet dhe kriteret për mekanizmat e inspektimit të brendshëm që mund të përcaktohet si "mekanizëm parandalues kombëtar" për të garantuar funksionimin efektiv dhe të pavarur të këtyre strukturave dhe për të siguruar se ato do të jenë të lira nga çfarëdo ndërhyrje e panevojshme. OPCAT nuk përshkruan ndonjë formë të veçantë të mekanizmave kombëtare parandalues duke lejuar që shtetet palë të kenë fleksibilitet për të zgjedhur llojin e mekanizmit që është më i përshtatshëm për kontekstin e tyre të veçantë. Një mekanizëm kombëtar parandalues mund të jetë një institucion kombëtar i të drejtave të njeriut, një Avokat të Popullit, një OJQ, apo ndonjë organ i specializuar i ngritur posaçërisht për të monitoruar vendet e privimit të lirisë<sup>20</sup>. OPCAT u kërkon Shteteve Palë që të marrin parasysh Parimet e Parisit, që përcaktojnë kriteret për funksionimin efektiv të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, të tillë si garancitë e pavarësisë funksionale dhe financiare, bazat e tij të themelimit, përbërjen bazë pluraliste, etj..

### **Komiteti kundër Torturës (CAT)**

CAT përbëhet nga dhjetë ekspertë të pavarur të zgjedhur nga shtetet palë që shërbejnë në cilësinë e individit. Qëllimi i Komitetit është të monitorojë detyrimet e Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera, Çnjerëzore ose Poshtëruës e të Ndëshkimit "(1984). Të gjitha Shtetet Palë duhet të paraqesin raportet për Komitetin për masat që janë marrë për zbatimin e angazhimeve të marra përsipër nga nënshkrimi i traktatit. Komiteti shqyrton raportet në një takim publik. Neni 20 i Konventës i jep pushtet CAT për të marrë informacion dhe të hetojë mbi akuzat e praktikës sistematike të torturës në Shtetet Palë. CAT mund, nëse beson se ai ka marrë informacion të besueshëm se tortura është praktikuar sistematikisht në një Shtet Palë, të kryejë një hetim të fshehtë në bashkëpunim me shtetin në fjalë. Hetimi mund të përfshijë edhe kryerjen e një vizite.

### **Komiteti i Kombeve të Bashkuar për të Drejtat e Njeriut (HRC)**

HRC është themeluar nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) për të verifikuar nëse shtetet palë zbatojnë dispozitat e tij. HRC përbëhet nga 18 ekspertë të pavarur të caktuar nga Shtetet Palë duke shërbyer në cilësinë e individit. Të gjitha Shtetet Palë të Konventës duhet të paraqesin një raport mbi veprimet që ata janë duke marrë për t'u dhënë personave të drejtat e njohura nga Pakti. Në 1985 HRC vendosi të caktojë një Raportues Special për Torturën.

---

<sup>20</sup> Nenet 17-23 të Pjesës IV të OPCAT përcaktojnë detyrimet e shteteve palë në lidhje me mekanizmin kombëtar parandalues.

## **Raportuesi special për Torturën**

Raportuesi Special shqyrton çështjet që lidhen me torturën dhe shpeshësinë e kryerjes së aktiviteteve të torturës, si dhe masën e ushtrimit në praktikë të këtyre çështjeve. Kompetenca e tij/saj shtrihet në të gjitha shtetet anëtare të OKB-së. Raportuesi i paraqet çdo vit një raport me rekomandime Komitetit të të Drejtave të Njeriut (HRC). Informacioni merret nga individët, organizatat jo-qeveritare dhe burimet qeveritare. Raportuesi mund, me pëlqimin e qeverisë në fjalë, të vizitojë një vend për të mbledhur informacion të drejtpërdrejtë mbi rastet dhe situatat e pretenduara. Këto misione janë 'thjesht konsultative' dhe janë një mënyrë e mirë për të vëzhguar situatën dhe për të bërë më tej rekomandime të përshtatura me situatën.

## **Raportuesi special për ekzekutimet arbitrare dhe ekstra-ligjore**

Në vitin 1982 Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (1946) caktoi një Raportues Special për ekzekutimet ekstra-ligjore dhe arbitrare për të ndërhyrë në të gjitha rastet kur e drejta e jetës shkelet, sidomos si rezultat i torturës gjatë ndalimit/kufizimit të lirisë. Raportuesi pranon pretendimet, trajton urgjentisht ankimmimet që mund t'i paraqiten dhe mund të kryejë në vend misione hetimi dhe të vizitojë personat e privuar nga liria, me kusht që shteti në fjalë t'i japë leje. Çdo vit Raportuesi i paraqet një raport Komisionit. Në vitin 1992 Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut formoi një Grup Pune për Ndalimin Arbitrar, i përbërë nga pesë ekspertë të pavarur.

## **Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK)**

KNKK-ja është një organ i paanshëm, privat, humanitar, i themeluar në Gjenevë në vitin 1863. KNKK-ja synon të ofrojë mbrojtje dhe ndihmë të viktimave civile dhe ushtarake të konflikteve të armatosura. Përfaqësuesit e KNKK mund të vizitojnë personat e privuar nga liria dhe të kontrollojnë se ata nuk janë duke iu nënshtruar torturës. Konventat e Gjenevës (1949) garantojnë se përfaqësuesit e KNKK janë të autorizuar për "të shkuar në të gjitha vendet" ku personat mund të jetë të mbrojtur dhe do të ketë akses në të gjitha mjediset ku gjenden robër të luftës. Pozicioni neutral, i paanshëm dhe i pavarur i KNKK-së rezultoi në besim dhe bashkëpunim të mirë me autoritetet kombëtare dhe është konsideruar si thelbësore për suksesin e vizitave të KNKK.

## **Institucionet Evropiane**

### **Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT/KPT)**

KPT-ja është themeluar në 1987 nga Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese dhe u bë operativ në 1989. Edhe pse ky është një instrument jo-detyrues, ai është një mekanizëm i rëndësishëm për parandalimin e torturës në



Evropë. Puna është e bazuar në një sistem vizitash të shpallura dhe konfidenciale në të gjitha vendet e privimit të lirisë të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. KPT-ja monitoron shkallën në të cilën shtetet kanë zbatuar Rregullat Evropiane të Burgjeve. Pas çdo vizite, hartohet një raport mbi gjetjet dhe rekomandimet dhe i dërgohet qeverisë përkatëse. Raportet e KPT janë konfidenciale dhe publikohen vetëm në qoftë se qeveria e një vendi e kërkon këtë. Vizitat kryhen në ekipe të vogla të anëtarëve të KPT-së, të gjithë ekspertë të pavarur.

## **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)**

Shtetet anëtare të OSBE kanë miratuar masa efektive për ndalimin e torturës dhe të trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese. Një Shtet anëtar mund të kërkojë ndihmën e një misioni të ekspertëve të OSBE-së për të parë nëse mundësohet zgjidhja e një pyetje apo problemi. Misioni ka të drejtë për të bërë hetime, të vizitoj pa pengesa dhe të takohet me zyrtarë të ndryshëm, OJQ-të dhe/ose individë në mënyrë konfidenciale. Vërejtjet dhe komentet nga shteti pritës mund të diskutohen nga Këshilli i Lartë i OSBE-së.

### **2.4 Modelet evropiane në lidhje me strukturat e brendshme të llogaridhënies dhe aspektet organizative të tyre**

#### **2.4.1 Situata në Holandë**

Në Holandë ka tre organe kryesore përgjegjëse për inspektimin dhe monitorimin. Këto janë Këshilli për Administrimin e Drejtësisë Penale dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (RSJ), Inspektorati për Zbatimin e Sanksioneve (IST) dhe Komitetet Mbikëqyrës.

Çdo institucion penitenciar holandez ka Komitetin e tij Mbikëqyrës. Këto komitete u ngritën në vitin 1953 dhe përbëhen nga anëtarë të pavarur të shoqërisë civile. Anëtarët janë zakonisht përfaqësues të gjyqësorit, të avokatëve, botës akademike, në fushën e punës sociale dhe sektorët e tjerë të shoqërisë dhe të paktën një person me një formim mjekësor. Detyra e komiteve mbikëqyrëse është që të sigurohet, në emër të shoqërisë, që personat e privuar nga liria të marrin trajtim të përshtatshëm dhe të duhur. Anëtarët e Komiteteve Mbikëqyrëse shërbejnë si komisioner për një muaj dhe në këtë funksion ata merren me çfarëdo ankese dhe shqetësimi që personat e privuar nga liria mund të kenë. Komitetet mbikëqyrës kanë një rol ndërmjetës në mes personave të privuar nga liria dhe të institucioneve penale. Ankesat me rëndësi diskutohen në takimet mujore, të cilat ndiqen nga ana e drejtorit të institucionit.

Këshilli për Administrimin e Drejtësisë Penale dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (RSJ) është një organ i pavarur këshillues dhe gjyqësor. Këshilli ka dy detyra; administrimin e drejtësisë dhe dhënien e këshillave për mbrojtjen e të rinjve dhe zbatimin e dënimeve dhe urdhrave jo-ndëshkuese. Këshilli merr çdo vit rreth 3,300 ankesa. Këshilli fillimisht kishte një detyrë mbikëqyrëse, por kjo është marrë përsipër nga Inspektorati për Zbatimin e Sanksioneve (IST) në 2005. Këshilli ka 60 anëtarë: specialistë për ligjin penal, për të miturit në të drejtën familjare dhe shkencat e sjelljes, anëtarë të gjyqësorit dhe të profesioneve ligjore, zyrtarët e administratës publike, si dhe

një numër mjekësh. Këshilli është organ i pavarur, me anëtarë të cilët janë të emëruar nga Mbretëresha e Holandës, dhe nuk janë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë ose të organizatave të tjera aktive në përgjegjësinë e Këshillit.

Inspektorati për Zbatimin e Sanksioneve (IST) është themeluar në 2005 si një organ i pavarur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Detyrat e tij kryesore janë për të inspektuar zbatimin e sanksioneve dhe në veçanti në lidhje me "trajtimin" dhe "sigurinë" e personave të privuar nga liria. IST nëse konstaton incidente i raporton Ministrin të Drejtësisë. Raportet e vizitave botohen dhe bëhen publike.

#### **2.4.2 Situata në Angli dhe Uells**

Në Angli dhe Uells ka tre organe kryesore të inspektimit, dhe këto janë: Kryeinspektori i Burgjeve i Madhërisë së Saj, Avokati i Popullit për Burgjet dhe Shërbimin e Provës si dhe Bordet e Pavarur të Monitorimi (IMB).

Kryeinspektori i Burgjeve i Madhërisë së Saj kryen inspektime të veçanta në burgje, bën rishikime periodike tematike dhe hetim të incidenteve që ndodhin në burg. Çdo vit publikohet një raport që tërheq vëmendjen e mediave.

Avokati i Popullit për Burgjet dhe Shërbimin e Provës shqyrton ankesat nga të burgosurit, të dënuarit në periudhë prove dhe nga ata që mbahen në qendra emigracioni. Ai gjithashtu heton të gjitha vdekjet e të burgosurve, ndaluarve dhe të emigrantëve dhe atyre që janë vënë në provë. Avokati i Popullit për Burgjet dhe Shërbimin e Provës emërohet nga Ministri i Brendshëm dhe është plotësisht i pavarur nga Shërbimi i Burgjeve dhe Provës.

Çdo burg dhe qendër imigrimi ka një Bord të Pavarur Monitorimi (IMB), i njohur më parë si Bordi i Vizitorëve. Grupi përbëhet nga vullnetarë, të emëruar nga qeveria dhe që veprojnë si "vëzhgues" si për Shërbimin e Burgjeve ashtu dhe të publikut të gjerë, për të siguruar që standardet e duhura të kujdesit dhe të mirëqenies të ruhen. Anëtarët e IMB vizitojnë burgjet në baza javore për të monitoruar situatën dhe për t'u marrë me ankesat individuale të të burgosurve. Në dritën e disa modeleve Evropiane për monitorimin e brendshëm dhe të jashtëm, të inspektimit dhe të mbikëqyrjes së vendeve të privimit të lirisë, duhet theksuar se Shqipëria duhet të kenë organet e saj të efektshme dhe të pavarura të brendshme dhe të jashtme për të siguruar trajtimin në kohë dhe efektiv të ankesave dhe për më tepër, për të pasur një mbikëqyrje të plotë mbi institucionet e mbyllura në mënyrë që të garantojë sigurinë dhe trajtimin e personave nën kujdesin e tyre.

Në sesionet në vijim do të bëhet një analizë e detajuar e kuadrit ligjor dhe çka është më e rëndësishme, do të paraqitet analiza e gjetjeve lidhur me zbatimin e legjislacionit në këtë drejtim, si dhe përfundime konkrete për gjendjen aktuale të zhvillimeve. Gjithashtu, do të bëhen prezent dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes aktuale.

### **III. E drejta e kërkesës dhe e ankimit – legjislacioni shqiptar në këndvështrim të standardeve ndërkombëtare**

E drejta e kërkesës dhe e ankimit në Shqipëri për personat e privuar nga liria është një e drejtë me karakter kushtetues, e cila merr rëndësi të veçantë për këto kategori individësh. Kështu Kushtetuta jonë në pjesën e dytë të saj, sanksionon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, qofshin ato me natyrë vetjake, politike, social-ekonomike dhe kulturore. Në këtë drejtim dhe për efekt të objektit të këtij studimi, do të ndalesha veçanërisht në nenin 48 të Kushtetutës i cili parashikon shprehimisht se: *“Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.”* Dënimi i heqjes së lirisë duhet të bëhet në kushte materiale dhe morale që sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor. Zbatimi i rregullave, i ligjeve, duhet të bëhet në mënyrë të paanshme. Nuk duhet të ketë diskriminim për arsye të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik, origjinës kombëtare ose shoqërore, statusit të lindjes, atij ekonomik, etj. Secilit person të privuar nga liria duhet t’i respektohet e drejta e ushtrimit të besimit fetar dhe vlerave kulturore- morale të grupit të cilit ai i përket. Në bazë të ligjit nr. 8328, dt. 16.04. 1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve”*, i ndryshuar, personave të privuar nga liria u njihen një sërë të drejtash themelore, ku si një nga të drejtat themelore përmendet ajo e kërkesë-ankesës.

Në vijimësi të këtij kapitulli do të paraqitet një analizë e bazës ligjore dhe strukturave të ngritura për zbatimin e tij në këtë fushë. Analiza e mangësive të bazës ligjore dhe gjetjet nga zbatimi i ligjit në praktikë do të trajtohet në kapitull më vete.

#### **3.1. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar nga policia**

##### **3.1.1 Të drejtat që u njihen personave të shoqëruar në polici**

Në nenin 11 të Ligjit ‘Për Policinë e Shtetit’, pika 6, shoqërimi përkufizohet si vijon: *‘Shoqërimi, në kuptimin e këtij ligji, nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrativ dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimit në zyrat e policisë, me ose pa vullnetin e tij’.*

Në përkufizimet e ligjit *“Për policinë e Shtetit”*, jepet edhe nocioni i shoqërimit e konkretisht neni 11/6 parashikon se *‘Shoqërimi, në kuptimin e këtij ligji, nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrative dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimit në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij’.*

Gjithashtu, policia bën shoqërimin e personit në ambientet e saj derisa çështja, për të cilën është kryer shoqërimi, verifikohet maksimalisht deri në 10 orë. Shoqërimi në polici bëhet për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; si dhe kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë.

Personat e shoqëruar kanë të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tyre<sup>21</sup>. Ata duhet të njoftohen menjëherë nga punonjësi i policisë për shkaqet e shoqërimit. Personat e shoqëruar mbahen në mjedise të ndryshme nga ato të personave të ndaluar ose të arrestuar. Për shoqërimin dhe mbajtjen e personave në zyrat e policisë, punonjësi i policisë bën dokumentimin e veprimit dhe njofton menjëherë eprorin e vet ose organin e interesuar për sqarimin e çështjes. Në të gjitha rastet e shoqërimit dhe mbajtjes në zyrat e policisë, merren parasysh kushtet personale dhe familjare të personit që shoqërohet.

Kur shoqërohet në polici, personi jo vetëm duhet të njoftohet menjëherë për arsyet e shoqërimit, por atij duhet t'i jepet menjëherë mundësia për të njoftuar një të afërm ose një person të cilit ai i beson. Kur i shoqëruari është i mitur, atëherë në çdo rast njoftohet menjëherë personi përgjegjës për mbikëqyrjen e tij<sup>22</sup>. E njëjta gjë vlen edhe për të rriturit, për të cilët është caktuar një kujdestar.

Në lidhje me shoqërimin në polici, femrat dhe meshkujt shoqërohen në mjedise të veçuara nga njëri-tjetri dhe po ashtu të miturit shoqërohen në mjedise të veçanta nga ato të të rriturve.

Statusi i një të arrestuari/ndaluar përcaktohet nga Kodi i Procedurës Penale (KPP); po ashtu edhe garancitë procedurale të këtyre personave. Gjatë kohës që personi është i ndaluar/arrestuar ndaj tij në asnjë rast nuk mund të ushtrohet dhunë apo çdo formë tjetër keqtrajtimi<sup>23</sup>. Personi ka të drejtën e mbrojtjes e cila duhet t'i garantohet në çdo fazë dhe gjendje të procedimit. Po ashtu, KPP parashikon se në rast procedimi në kundërshtim me ligjin ose në rast dënimi të padrejtë, personit i kthehen të drejtat dhe shpërblehet për dëmin e pësuar<sup>24</sup>.

### **3.1.2 Të drejtat që u njihen personave të ndaluar/arrestuar**

Në lidhje me respektimin e të drejtave të personave që ndalohen/arrestohen apo shoqërohen nga policia marrin rëndësi të veçantë: e drejta për të pasur avokat mbrojtës, e drejta që atij t'i njoftohet arsyeja e ndalimit/arrestimit si dhe ky fakt t'i bëhet me dije familjarëve apo personave të tjerë përgjegjës/të interesuar, si dhe e drejta për të kërkuar ekzaminimin mjekësor. Në çdo rast, punonjësit e policisë duhet t'i bëjnë të ditur personit të shoqëruar, ndaluar/arrestuar të drejtat e tij. Gjithashtu mbrojtësi duhet të ketë akses jo vetëm të kontaktojë në çdo kohë me të arrestuarin/ndaluarin, të ketë akses në të dhënat e mbledhura si dhe të asistojë atë gjatë pyetjes, por edhe të garantohet në ambientet e policisë konfidencialiteti dhe privatësia e bisedës me klientin e tij. Për të miturin, përveç mbrojtësit që duhet domosdoshmërisht të jetë i pranishëm, kërkohet detyrimisht edhe njoftimi dhe prania e prindit apo kujdestarit ligjor si dhe e psikologut për ta asistuar atë. Po ashtu, ambientet dhe kushtet e trajtimit në ambientet e policisë duhet të respektojnë parimet e trajtimit human në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare.

Nuk ka në ligjin “Për policinë e shtetit” një dispozitë të veçantë që të parashikojë mundësinë e ankimit dhe procedurat përkatëse të të shoqëruarve apo ndaluarve/arrestuarve gjatë qëndrimit

<sup>21</sup> Neni 101 i Ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për policinë e Shtetit”

<sup>22</sup> Neni 107 i Ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për policinë e Shtetit”

<sup>23</sup> Neni 5 i KPP.

<sup>24</sup> Neni 9 i KPP

në polici për efekt shkeljesh të të drejtave të tyre. Kjo gjë është bërë vetëm pas daljes nga komisariatet e policisë<sup>25</sup>.

### **3.1.3 Mekanizmat e brendshëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave në policinë e shtetit**

Për sa i takon kontrolleve, në vendet e ndalimit/arrestimit apo shoqërimit ato kryhen nga inspektorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që kanë në fokus të kontrollit ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga stafi policor në fazën e arrestimit/ndalimit apo shoqërimit, kushtet dhe trajtimin e tyre gjatë kohës që qëndrojnë në këto ambiente si dhe respektimin e të drejtave të tyre gjatë kësaj periudhe.

Në ligjin për SHKB-në e Policisë ka ndër të tjera në funksionet që i janë njohur këtij shërbimi, kompetenca që në kontrollet që bëjnë në komisariatet e policisë të shohë edhe respektimin e detyrimeve nga ana e punonjësve të policisë në lidhje me garantimin e të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar gjatë qëndrimit në këto ambiente.

Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se personat e ndaluar/shoqëruar/arrestuar duhet të vihen në dijeni mbi rregullat që zbatohen në komisariatet e policisë, si dhe për të drejtat dhe detyrimet që kanë qytetarët.

Ndonëse ligji “Për policinë e shtetit”, ndër të tjera përmban edhe dispozita me natyrë procedurale, në të nuk gjen pasqyrim të qartë e drejta e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar për të bërë kërkesë/ankesë ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të policisë në garantimin e të drejtave të tyre.

### **3.1.4. Mekanizmat e jashtëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave në policinë e shtetit**

Në rast ankimi të këtyre personave për trajtimin e tyre gjatë arrestimit/ndalimit apo shoqërimit ata mund t’i drejtohen Avokatit të Popullit (shih më poshtë tek pjesa për AP), organizatave të ndryshme që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe Gjykatës. Për efekt të ankimimit gjatë fazës së procedimit, zbatohen rregullat në lidhje me afatet, procedurën dhe mënyrën e ankimimit në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

## **3.2. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e privuar nga liria në paraburgime dhe burgje**

Ekzekutimi i vendimeve që përmbajnë dënim, kufizon vetëm ato të drejta, në atë masë dhe kohë, sa përcakton vendimi penal, duke respektuar të gjitha të drejtat e tjera të njohura ligjrisht, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj. Personi i dënuar në të gjitha fazat e ekzekutimit të vendimit, gëzon të drejtat që i takojnë sipas këtij ligji dhe, kur nuk i njihen ose i cenohen ato, kërkon mbrojtjen dhe realizimin e tyre në mënyrën që përcaktohet në ligj<sup>26</sup>. Për

<sup>25</sup> Shih raportin e fundit të Avokatit të Popullit.

<sup>26</sup> Shih ligjin nr. 8331, dt. 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar

mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tij, të paraburgosurit/dënuarit i garantohet komunikimi me organet kompetente si p.sh, ankimi në gjykatë dhe mbrojtja me avokat.

### **3.2.1. Të drejtat që u njihen personave të privuar nga liria në burgje dhe paraburgime**

E drejta e kërkesës dhe e ankimit si një e drejtë me karakter kushtetues, ka gjetur pasqyrim dhe në ligjin nr. 8328, dt. 16.04. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosur”, i ndryshuar. Konkretisht në nenin 8 të këtij ligji parashikohet se të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme dhe në mënyrë individuale.

Nga pikëpamja formale ankesat mund të bëhen me gojë ose me shkrim edhe në zarf të mbyllur<sup>27</sup>. Me anë të këtyre ankesave të dënuarit mund t’i drejtohen organeve të ndryshme. Pra, kur e çmojnë të arsyeshme të paraburgosurit /të dënuarit mund t’i drejtohen çdo organi shtetëror apo organizate joqeveritare, të vendit ose të huaja. Për shqyrtimin e këtyre kërkesave dhe ankesave janë vendosur afate të përgjithshme. Konkretisht ankesat duhet të shqyrtohen brenda një muaji nga paraqitja e tyre, por në dispozita të veçanta mund të parashikohen edhe afate të posaçme.

I dënuari ka të drejtë të ankohet në instancat më të larta të sistemit të burgjeve dhe, kur kjo ankesë nuk zgjidhet në rrugë administrative, apo ndaj vendimit të dhënë, i burgosuri mund t’i drejtohet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni<sup>28</sup>. Gjithashtu, çdo i paraburgosur/dënuar ka të drejtë të informohet për rregullat e brendshme dhe disiplinore të institucionit si dhe për çdo akt që i jep atij mundësinë të njihet me të drejtat dhe detyrat për t’iu përshtatur jetës, aty ku ai kryen dënimin<sup>29</sup>.

Në bërjen e kërkesës/ankesës individuale, kuadri ligjor në fuqi nuk përmend faktin që përfaqësuesi ligjor/mbrojtësi të ketë të drejtën të bëjë e paraqesë një ankesë<sup>30</sup>, ndërkohë që standardet ndërkombëtare e parashikojnë një gjë të tillë. Megjithatë, në praktikë një gjë e tillë realizohet, pra jo vetëm i dënuari/paraburgosuri por edhe përfaqësuesi i tij ligjor mund të paraqesë një ankesë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Gjithashtu, në praktikë ankesa mund të bëhet edhe nga një OJF<sup>31</sup>.

Ajo që duhet theksuar për këtë pjesë e që buron nga standardet ndërkombëtare është se për çdo kërkesë/ankesë që mund të ketë një i dënuar/paraburgosur atij duhet t’i krijohet mundësia që jo vetëm personalisht, por t’i mundësohet aksesit që këtë ankesë ta bëjë përfaqësuesi i tij ligjor apo familjarët e tij. E njëjta gjë vlen edhe për OJF-të, që mund të paraqesin një kërkesë/ankesë me natyrë individuale në emër dhe për llogari të personit të privuar nga liria, me pëlqimin e tij/saj. Ky standard ndonëse praktikisht mundësohet në praktikë, duhet të gjejë pasqyrimin e tij të qartë në ligj.

<sup>27</sup> Shih nenin 49 të ligjit nr. 8328, dt. 16.04. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosur”, i ndryshuar.

<sup>28</sup> Shih nenin 50, paragrafi 2, i ligjit nr. 8328, dt. 16.04. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosur”, i ndryshuar

<sup>29</sup> Neni 5 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve

<sup>30</sup> Shih gjetjet në studimin “*Assessing Prison complaints mechanism sin CEE and FSU regions*”, mbështetur nga Komiteti Hungarez i Helsinkit në bashkëpunim me OSI Budapest, 2011, fq. 20.

<sup>31</sup> Po aty.

Në trajtimin e mekanizmit të kërkesë/ankesave ka rëndësi gjithashtu respektimi i parimit të konfidencialitetit, i cili theksohet edhe në aktet ndërkombëtare të tilla si: CAT, Grupi i Parimeve të OKB-së për mbrojtjen e të gjithë personave që i nënshtrohen çdo forme burgimi apo paraburgimi, REB dhe që gjejnë pasqyrim edhe në legjislacionin tonë të brendshëm<sup>32</sup>. Kështu, të dënuarit/paraburgosurit kanë të drejtën që kërkesat apo ankesat e tyre t'ia parashtrajnë drejtpërdrejt dhe personalisht drejtorit të institucionit. Po ashtu, këtë gjë mund ta bëjnë edhe me anëtarë të tjerë të personelit sipas llojit të kërkesë/ankesës<sup>33</sup>. Për më tepër, legjislacioni parashikon edhe bërjen e kërkesave edhe me zarf të mbyllur. Gjithsesi, duhet theksuar se rregullat procedurale për investigimin e ankesave përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve dhe në rregulloren e brendshme të institucioneve (jo në ligj)<sup>34</sup>.

### **3.2.2. Mekanizmat e brendshëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të personave të privuar nga liria në burgje dhe paraburgime**

Gjatë pranimit në institucion, i paraburgosuri /i dënuari njihet me të drejtat dhe detyrat, si dhe me mënyrën e paraqitjes së kërkesave dhe ankesave<sup>35</sup>. Atij/asaj duhet t'i krijohet mundësia që çdo ditë, me shkrim ose përjashtimisht në mënyrë verbale nëpërmjet personelit të institucionit, të paraqesë kërkesë/ankesë, ose të kërkojë takim me drejtorin e institucionit apo personelin përgjegjës. Personat e autorizuar duhet të organizojnë takime me të paraburgosurit/dënuarit për t'u krijuar mundësinë e paraqitjes së kërkesë-ankesave të tyre.

Kërkesat ose ankesat, pasi regjistrohen në një libër të veçantë, i dorëzohen drejtorit të institucionit, i cili ka detyrimin të caktojë punonjës in përkatës për zgjidhjen dhe kthimin e përgjigjes të burgosurit. Për kërkesat dhe ankesat që i drejtohen institucionit, përgjigja duhet të jepet brenda 15 ditëve<sup>36</sup>. Këto ankesa e kërkesa regjistrohen në një regjistër të veçantë që duhet të mbahet nga çdo institucion<sup>37</sup>.

Të paraburgosurit/dënuarit mund t'ua paraqesin kërkesat apo ankesat me gojë ose me shkrim edhe me zarf të mbyllur, drejtorit të institucionit, inspektorëve, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Ministrin të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Prokurorit, Gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit, Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, apo institucioneve të tjera shtetërore, personave që vizitojnë institucionet sipas nenit 43 të ligjit nr. 8328, dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve”, i ndryshuar. Këta persona kanë të drejtë të marrin përgjigje brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi. Afati i përgjithshëm, siç u përmend edhe më sipër, është 1 muaj.

---

<sup>32</sup> Shih studimin “*Assessing Prison complaints mechanism sin CEE and FSU regions*”, mbështetur nga Komiteti Hungarez i Helsinkit në bashkëpunim me OSI Budapest, 2011, pg. 27.

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> Shih studimin “*Assessing Prison complaints mechanism sin CEE and FSU regions*”, mbështetur nga Komiteti Hungarez i Helsinkit në bashkëpunim me OSI Budapest, 2011, pg. 26.

<sup>35</sup> Neni 56 “Kërkesat dhe ankesat” i VKM nr. 303, datë 25.3.2009 ndryshuar me V.K.M-ne nr. 187 date 17.03.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 303 datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

<sup>36</sup> Neni 56 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

<sup>37</sup> Neni 8/germa dh, i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi, rezulton se ka një mekanizëm të brendshëm për kontrollin/monitorimin e respektimit të të drejtave të personave të paraburgosur /dënuar në institucionet penale, për të garantuar një trajtim sa më human të tyre në përputhje me standardet e vendosura për këtë qëllim. Inspektimi dhe mbikëqyrja e burgjeve kryhet nëpërmjet inspektorëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe inspektorëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Kështu, në VKM nr. 303, datë 25.3.2009 ndryshuar me V.K.M-në nr. 187 datë 17.03.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 303 datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” në nenin 94/1 të saj me titull “Inspektimi në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)” përcaktohen strukturat përgjegjëse për kontrollin e veprimtarisë së IEVP-ve, kompetencat e tyre dhe procedurat që ndiqen në këtë rast. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dërgon pranë institucioneve penale grupe inspektimi, të përbëra nga specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët bëjnë verifikime për çështje të caktuara në urdhrin e nxjerrë për këtë qëllim. Në urdhër përcaktohet edhe objekti i kontrollit, sipas problematikës përkatëse. Në përfundim të inspektimit, grupi harton një akt kontrolli në prani të personave të kontrolluar, duke bërë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara. Kur konstatohen shkelje, grupi i inspektimit i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve marrjen e masave konkrete disiplinore ndaj personave përgjegjës për shkeljen. Megjithatë, mendojmë se duhet të ketë modalitete dhe protokolle të posaçme se si do të kryhet kontrolli. Po ashtu, me rëndësi është edhe transparenca e inspektimeve, që në rast se është vendi, jo vetëm të lihen rekomandime në akt/kontrollin e hartuar me këtë rast, por edhe të monitorohet situata nga strukturat kompetente për të parë nëse vërejtjet/rekomandimet janë reflektuar në kohë.

Ndaj vendimit të parë, personi i privuar nga liria ka të drejtën e apelit, në një instancë më të lartë të sistemit të burgjeve, dhe gjithashtu edhe në gjykatë si pjesë e rishikimit gjyqësor të një vendimmarrje administrative.

Gjithashtu, pjesë kontrolluese e personelit të burgjeve është Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve pranë Ministrisë së Drejtësisë<sup>38</sup>. Fusha e veprimtarisë së këtij Shërbimi është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi paraprak i veprimtarisë kriminale, të kryer nga punonjës të policisë së burgjeve, nga struktura të tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për çështje që lidhen me sigurinë në burgje. Ndonëse SHKB kryen inspektime/kontrolle në burgje, inspektimet e saj nuk na rezultoi se bëhen transparente. Megjithatë, nuk kanë munguar masat e ndryshme disiplinore ndaj stafit për shkelje të ndryshme të konstatuara, si rezultat i një procedure ankese të brendshme. Nga monitorimi në institucione, nuk morëm dot informacion relevant se sa kanë qenë dhe çfarë objekti kanë pasur këto masa ndaj stafit kurdoherë që janë vërejtur shkelje në zbatimin e detyrës ndaj personave të privuar nga liria.

---

<sup>38</sup> Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, kryen detyrat funksionale në zbatim të ligjeve Nr 9397 dt 12.05.2007, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, Nr 7895, dt 21.01.1995, ” Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë “, Nr 7905, dt 21.03.1995, “ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë “ dhe Nr 8677, dt 02.11.2000, “Për Organizimi dhe Funksionimi i Policisë Gjyqësore“.



### 3.2.2.1. Inspektori për Çështjet Ligjore dhe të Sigurisë në DPB

Inspektori për Çështjet Ligjore dhe të Sigurisë ka disa kompetenca dhe detyra funksionale të rëndësishme në lidhje me respektimin e parimeve dhe detyrimeve ligjore për trajtimin e të dënuarve dh respektimin e të drejtave të tyre.

Këta inspektorë kryejnë inspektimin e vazhdueshëm të aktivitetit në burgje dhe paraburgime, përkatësisht në lidhje me përmbushjen e detyrave funksionale të sektorëve të policisë, ligjor apo edukativ në institucione (të paktën 3 herë/vit për çdo institucion). Gjithashtu, ata kryejnë inspektime periodike - të planifikuara dhe specifike, në mënyrë të pavarur, të drejtpërdrejtë dhe me tagra të plota. Për më tepër ata ndjekin periodikisht zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë apo në përfundim të inspektimeve, si dhe propozojnë masat për përgjegjësit lidhur me rekomandimet e pazbatuara duke bërë analiza të mirëfillta të pasojave të moszbatimit të masave të rekomanduara si dhe përgatisin raportin vjetor të punës së kryer gjatë një viti duke paraqitur statistika të sakta lidhur me numrin e inspektimeve, gjetjet, masat e propozuara, masat e zbatuara etj. Mendojmë se duhet të ketë modalitete dhe protokolle të posaçme se si do të kryhet kontrolli/inspektimi. Po ashtu me rëndësi është edhe transparencja e këtyre inspektimeve, gjë që deri më tani është trajtuar vetëm si çështje e brendshme e këtyre institucioneve të privimit të lirisë apo në vijë hierarkike trajtimi i tyre nga strukturat e prora.

Detyrë e rëndësishme funksionale e tyre është shqyrtimi i kërkesë - ankesave që vijnë në drejtim të sistemit të burgjeve dhe verifikimi në vend i situatave të caktuara të cilat kërkojnë një vendimmarrje të drejtë dhe të shpejtë, nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Ekzistenca e këtyre inspektorëve shërben si një mekanizëm i brendshëm i cili ndihmon në evidentimin në kohë të kërkesave-ankesave të personave të dënuar/paraburgosur dhe jep mundësinë në adresimin e saktë dhe të menjëhershëm për zgjidhje të tyre.

Në lidhje me varësinë, Inspektori për Çështjet Ligjore dhe të Sigurisë raporton drejtpërdrejtë tek Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve lidhur me gjetjet e inspektimeve. Në përfundim të inspektimit të kryer, inspektori i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm masa konkrete për përmirësimin e punës në mbështetje të rezultateve të inspektimeve në sektorët ku është kryer inspektimi. Gjithashtu, këta inspektorë i propozojnë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, dhe pas miratimit të tij, drejtuesit të institucionit, pezullimin deri në shqyrtimin nga organi përkatës të veprimeve të kundërligjshme<sup>39</sup>. Gjithashtu, krahas inspektorëve të DPB-së, inspektime kryhen edhe nga sektorë të tjerë në DPB në çështje respektive që kanë të bëjnë me zbatimin e detyrave funksionale të sektorëve të varësisë. Kështu inspektime kryhen periodikisht nga sektorët e Problemeve Shoqërore, Ligjore, Shëndetësisë, Policisë dhe Logjistikës.

---

<sup>39</sup> Veprime të cilat dëmtojnë rëndë interesat e institucionit dhe/ose janë të arsyetuara e përbëjnë vepër penale për t'u ndjekur më pas edhe penalisht.

### **3.2.3. Mekanizmat e jashtëm të monitorimit dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të personave të privuar nga liria në burgje dhe paraburgime**

Përveç mekanizmit të brendshëm të monitorimit/kontrollit të kërkesë-ankesave, me rëndësi është edhe mekanizmi i jashtëm, si një garanci më shumë në respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në burgje, paraburgime dhe komisariate. Kështu, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe siç u përmend edhe më lart, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan Gjykata dhe Prokurori i ngarkuar me mbikëqyrjen në ekzekutim, Avokati i Popullit, si institucion kushtetues garant i respektimit të të drejtave dhe lirive të individit nga administrata publike<sup>40</sup>, si dhe organizata të shoqërisë civile apo organizma ndërkombëtare që operojnë në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut.

Institucioni penal mundëson takime konfidenciale të të paraburgosurve/burgosurve me anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës, Avokatin e Popullit dhe punonjësit e zyrës së tij, mbrojtësin e kërkuar nga i burgosuri ose të caktuar kryesisht, përfaqësues të OJF-ve, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut ose të organizmave ndërkombëtare. Këto takime në asnjë rast nuk mund të bëhen në prani të stafit të institucionit. Ato duhet të zhvillohen në ambiente larg prezencës së stafit dhe larg mundësisë për ta dëgjuar bisedën, për të garantuar kështu parimin e konfidencialitetit.

Siç është theksuar edhe më parë i dënuari ka të drejtë që në rastet kur ankesa nuk zgjidhet administrativisht brenda sistemit të burgjeve, apo ndaj vendimit të dhënë, t'i drejtohet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni.

Gjithashtu, në kuadrin e përmbushjes së rolit të tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (CPT), edhe Avokati i Popullit kryen inspektive në burgje dhe jep rekomandimet përkatëse.

#### **3.2.3.1. Prokurori i ngarkuar me mbikëqyrjen në ekzekutim**

Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e ligjit, të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit, të ndërhyjë në organet kompetente ose të paraqesë kërkesë në gjykatë për rivendosjen e ligjit e të së drejtës së shkelur dhe vënien e shkaktarëve para përgjegjësisë sipas ligjit<sup>41</sup>. Format e kontrollit të prokurorit janë disa dhe konkretisht nëpërmjet<sup>42</sup>:

1. marrjes së njoftimit për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit nga organi përkatës;
2. shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të të dënuarve dhe mbrojtësit të tij;

---

<sup>40</sup> Shih nenin 60 të Kushtetutës së RSH: "Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike".

<sup>41</sup> Neni 9 i ligjit nr. 8331, dt. 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar

<sup>42</sup> Neni 53 i ligjit nr.8331, dt. 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar

3. kërkimit të informacioneve dhe verifikimeve të drejtpërdrejta mbi dokumente ose në vendin e kryerjes së dënimit në prani të personit zyrtar përkatës;
4. marrjes dhe verifikimit të njoftimeve për fakte dhe rrethana që ndikojnë në ekzekutimin e vendimeve;
5. marrjes së mendimit të specialistëve të fushave të ndryshme;
6. bashkëpunimit me kontrollin e brendshëm të organit ku ekzekutohet vendimi ose të institucioneve shtetërore të kontrollit administrativ.

Për verifikimet që bëhen në vende ku ekzekutohet vendimi ose në vende të tjera, prokurori mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga personi zyrtar i pranishëm, i cili ka të drejtë të pasqyrojë pretendimet e tij. Ligji përcakton detyrimin që për verifikimet mbi ankesën e të dënuarit apo mbrojtësit të tij, ky i fundit duhet të jetë i pranishëm kur e kërkon. Pas verifikimit, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës për rivendosjen e rregullit të shkelur ose njohjen e së drejtës të të dënuarit për rastet në kompetencë të saj. Në rastet e tjera prokurori ndërhyt në organet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimit ose në organe të tjera kompetente, për rivendosjen e ligjit ose të drejtës së cenuar, duke caktuar dhe afatet përkatëse. Kur nuk ka pengesë ligjore, prokurori urdhëron rivendosjen e menjëhershme të ligjit dhe të së drejtës së shkelur<sup>43</sup>.

Kur është rasti, prokurori paraqet kërkesë në organin kompetent për vënien para përgjegjësisë disiplinore e administrative ose të zhdëmtimit ndaj personave që kanë lejuar ose kanë kryer shkelje. Kërkesa shqyrtohet detyrimisht nga organi kompetent dhe përfundimi i njoftohet prokurorit. Megjithatë, nga pikëpamja e zbatimit praktik, rezulton se pak ushtrohen nga prokurori këto kompetenca në lidhje me mbikëqyrjen dhe format e kontrollit që përshkruam më sipër. Kjo kërkon që prokurori i ngarkuar me mbikëqyrjen në ekzekutim të luajë një rol më aktiv në përputhje me kompetencat ligjore, kur bëhet fjalë për kontrollin në institucionet penale të privimit të lirisë.

### **3.2.3.2. Komisioni mbikëqyrës i ekzekutimit të dënimeve me burgim**

Ky Komisioni është organ këshillimor për zbatimin e ligjit në ekzekutimin e dënimeve me burgim dhe mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve që ngrihet e funksionon pranë Ministrisë të Drejtësisë dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë vendin. Anëtarët e tij janë përfaqësues të institucioneve të ndryshme të shtetit<sup>44</sup> dhe gjatë ushtrimit të detyrës kanë atributet dhe

<sup>43</sup> Neni 55 i ligjit nr. 8331, dt. 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar

<sup>44</sup> Sipas Nenit 61 të ligjit nr. 8331, dt. 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar me titull “Caktimi i anëtarëve”, përcaktohet përbërja e këtij komisioni si më poshtë:

*“Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri caktojnë si anëtarë nga një person që nuk ka funksione publike.*

*Ministrat që mbulojnë shëndetësinë, ushqimin, ndërtimin dhe kulturën, caktojnë nga një anëtar prej punonjësve të tyre, me kusht që të jenë specialistë në profilet përkatëse.*

*Ministri i Drejtësisë cakton një anëtar që nuk ka funksione publike, por që ka kushte për të qenë gjyqtar. Një anëtar caktohet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë”.*

përgjegjësitë ligjore të nëpunësit publik. Publikimi i të dhënave nga anëtarët bëhet me leje të Ministrisë të Drejtësisë. Në çdo rast zbatohen rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror. Anëtarët e Komisionit rezervojnë të drejtën të japin informacione për veprimtarinë dhe konstatimet në organin që i ka caktuar.

Sipas ligjit, Komisioni duhet të mbledhet rregullisht një herë në tre muaj dhe në raste të veçanta me kërkesë të kryetarit edhe më parë. Mbi bazën e ankesave ose njoftimeve të paraqitura, komisioni ose anëtari i autorizuar prej tij ka të drejtë të kryejë verifikime edhe pa paralajmërim në institucionet e dënimit, të marrë takim në çdo kohë me të paraburgosur/dënuarit të veçantë, të kërkojë sqarime dhe të këqyrë dokumentet dhe mjediset, si dhe të bëjë verifikimet e tjera të nevojshme. Veprimet kryhen në prani të drejtorit të institucionit ose të ngarkuarit prej tij, me përjashtim të takimit me të paraburgosur/dënuarit, që mund të bëhet edhe pa praninë e tyre.

Komisioni rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e ligjit apo të së drejtës së shkelur dhe i parashtron Ministrinë të Drejtësisë konstatimet, duke i kërkuar marrjen e masave përkatëse. Ministri i Drejtësisë duhet të kthejë përgjigje për masat e marra brenda 30 ditëve. Kur marrja e masave është në kompetencë të prokurorit dhe gjykatës, Ministri i Drejtësisë i paraqet materialet prokurorit kompetent. Kur nga konstatimet çmohet se ka vend për ndryshime, shtesa ose për akte të reja ligjore e nënligjore, Komisioni bën propozime në organet kompetente.

### **3.2.3.3. Mekanizmi i Kontrollit për Parandalimin e Torturës (MKPT) pranë Avokatit të Popullit**

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur<sup>45</sup>, përfshirë këtu edhe personat e privuar nga liria në ambientet e policisë, burgjeve apo paraburgimeve. Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit. Për ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Popullit nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës. Avokati i Popullit nuk pranon ankesa ose kërkesa anonime<sup>46</sup>.

Avokati i Popullit mund të mos fillojë ose ndërpret hetimin në qoftë se e njëjta çështje është vendosur ose është në shqyrtim nga prokuroria apo gjykata. Në këto raste, ai ka të drejtë të kërkojë informacion pranë këtyre organeve, të cilat duhet t'u përgjigjen kërkesave të tij sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë. Avokati i Popullit, pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, vendos<sup>47</sup>:

---

<sup>45</sup> Ligji nr.8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

<sup>46</sup> Neni 15 i Ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

<sup>47</sup> Neni 17 i Ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

- a. ta pranojë ose jo çështjen për shqyrtim;
- b. t'i kthejë përgjigje të interesuarit, duke i treguar të drejtat dhe rrugët nëpërmjet të cilave ai mund ta mbrojë këtë të drejtë;
- c. t'ia kalojë çështjen organit kompetent.

Në të gjitha rastet e mësipërme, Avokati i Popullit njofton të interesuarit brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës, kërkesës ose njoftimit. Pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim, Avokati i Popullit<sup>48</sup> ndërmer vetë një proces hetimi ose kërkon shpjegime nga organet e administratës, si dhe prokuroria, në rastet e arrestimeve dhe ndalimeve.

Me ratifikim nga Shqipëria të OPCAT-it u krijua pranë Avokatit të Popullit njësi që njihet si Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit johuman, çnjerëzor ose poshtërues dhe janë përcaktuar në ligjin "Për Avokatin e Popullit" kompetencat e tij. Në këtë kuadër, ky ndryshim u reflektuar edhe në ligjin Nr. 8328, dt. 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

Kështu, Avokati i Popullit, nëpërmjet MKPT mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve. Ky Mekanizëm monitoron rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgimit, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi johuman, çnjerëzor apo degradues; si dhe paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e këtyre individëve dhe të parandalohet tortura dhe çdo trajtim ose dënim johuman, çnjerëzor ose poshtërues.

Sipas të dhënave nga Avokati i Popullit, MKPT (njësia për parandalimin e torturës), gjatë vitit 2010, ka kryer rreth 160 inspektive, ri-inspektive, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita në vendet e privimit të lirisë përfshirë këtu institucione si: komisaritet e policisë, paraburgimet dhe burgjet. Gjatë këtij viti MKPT ka marrë dhe ka trajtuar rreth 380 ankesa të cilat janë marrë gjatë takimeve me individë të privuar nga liria, apo të dërguara pranë zyrës së Avokatit të Popullit me anë të postës apo telefonatave. Për periudhën Janar-Gusht 2011 MKPT ka trajtuar 250 ankesa<sup>49</sup>.

#### Procedura e hetimit

Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë:

- a. të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.

<sup>48</sup> Neni 18 i Ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

<sup>49</sup> Si objekt kryesor i ankesave kryesisht kanë qenë kundërshtimet ndaj hetimit dhe vendimeve gjyqësore, refuzimi i lejeve nga administrata e burgjeve, ankesa për ushqimin, mungesën dhe dyshimet mbi cilësinë e ujit në burg, ndihme dhe këshillim juridik, ankesa për mos dhënie të ndihmës shëndetësore të kualifikuar, për pengimin në ndjekjen e studimeve, ankesa për dhunë nga policia e burgjeve, kërkesa për llogaritjen e saktë të viteve të vuajtjes së dënimit, ekzekutime vendimesh për takime me fëmijë si pasojë e divorceve etj. .

b. të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin;

c. të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet;

ç. të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

a. i shpjegon ankuesit se të drejtat e tij nuk janë shkelur;

b. paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;

c. paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen; Mos shqyrtimi i rekomandimit brenda 30 ditëve pezullon aktet ose veprimet e paligjshme ose të parregullta.

ç. i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale; ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara.

d. për shkelje të rënda, të vëna re, i propozon çdo organi, shkarkimin e funksionarëve që janë kompetencë e tyre;

dh. për shkelje të të drejtave nga organet e pushtetit gjyqësor, pa ndërhyrë në procedurën që ato zbatojnë, Avokati i Popullit i bën të ditur shkeljet organit kompetent;

e. u rekomandon personave të dëmtuar të paraqesin padi në gjykatë;

Paraqitja e rekomandimit pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit. Rastet e mësipërme nuk përjashtojnë njëri-tjetrin. Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ. Në rast se Avokati i Popullit nuk i quan të mjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta ndjekë çështjen tek organi më i lartë në hierarki. Në rastet e përsëritura, si dhe kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet edhe Kuvendit me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur<sup>50</sup>.

---

<sup>50</sup> Neni 23 i Ligjit nr.8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Kur Avokati i Popullit vëren se shkakun që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, ka të drejtë<sup>51</sup>:

a. t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

b. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mos shqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.

Për të ruajtur parimin e konfidencialitetit në marrjen e kërkesë –ankesave, Mekanizmi Kombëtar ka vendosur kuti postare në të gjitha institucionet penale ku të paraburgosurit/dënuarit hedhin vet kërkesë-ankesat e tyre dhe çelësin e kutive e kanë vetëm punonjësit e Mekanizmit Kombëtar.

#### **3.2.3.4. Gjykata**

Organet dhe institucionet ku ekzekutohet vendimi ose që janë të ngarkuara me mbikëqyrjen e ekzekutimit, si dhe organet eprore të tyre në kuadrin e kontrollit të brendshëm, të bëjnë verifikimet përkatëse. Për konstatimet, kur janë kompetente, marrin masa përkatëse, në të kundërtën kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit dhe, kur është rasti, nëpërmjet tij kërkojnë shqyrtimin e çështjes nga gjykata.

Gjykata që ka dhënë vendimin ose gjykata e vendit ku ekzekutohet dënimi, për çështjet në kompetencë të saj që dalin gjatë ekzekutimit, ka të drejtë të kërkojë njoftime nga prokurori dhe organi ku ekzekutohet vendimi dhe, kur e sheh me vend, kontrollon drejtpërdrejt rregullsinë e ekzekutimit.

I dënuari ka të drejtë të ankohet në instancat më të larta të sistemit të burgjeve dhe paraburgimeve, kur kjo ankesë nuk zgjidhet në rrugë administrative, apo ndaj vendimit të dhënë, i dënuari mund t'i drejtohet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni, e cila duhet të shprehet brenda 5 ditëve për pretendimin mbi të drejtën e shkelur si dhe kur është rasti urdhëron rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

#### **3.2.3.5. Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare**

Në komisariatet e policisë, institucionet e paraburgimit dhe burgjet, mund të kërkojnë informacione dhe sqarime edhe organe të tjera shtetërore dhe OJF lidhur me rregullsinë e ekzekutimit të vendimit dhe respektimin e të drejtave të të personave të privuar nga liria, duke rekomanduar marrjen e masave përkatëse nga organet shtetërore kompetente dhe kur e shohin

---

<sup>51</sup> Neni 24 i Ligjit nr.8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

me vend, të kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit. Monitorimi në këto institucione bëhet në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke respektuar në çdo rast privatësinë dhe konfidencialitetin e të dhënave. Hyrja në këto institucione e organizatave që monitorojnë respektimin e të drejtave të të dënuarve apo paraburgosurve bëhet në përputhje me Ligjin "për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve" dhe me nenin 66 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Për periudhën Janar 2011 - Gusht 2011 KShH-ja<sup>52</sup> ka pranuar 106 ankesa nga personat e privuar nga liria në paraburgim apo burgje. Numri i personave të cilët pretendojnë dhunë fizike ose psikologjike ka qenë 7 ankesa të marra gjatë kësaj periudhe. Është shumë e vështirë për të verifikuar pretendimet për dhunë dhe këto janë adresuar në prokuroritë përkatëse zyra. Janë rreth 50 ankesa të marra në lidhje me kushtet e këqija në institucione të ndryshme. Ka pasur 6 ankesa lidhur me mungesën e kujdesit shëndetësor për të burgosurit (të tilla si: Ndalimi i të burgosurit që të vizitohet nga një mjek privat, nuk është dërguar i burgosuri në Qendrën Spitalore të Burgjeve për trajtim të specializuar mjekësor dhe mungesa e sigurimit nga institucioni me trajtimin e duhur mjekësor për diagnozën e të dënuarit). Pretendime për shkelje të të drejtave të personave të privuar nga liria e tyre kanë qenë 23 ankesa, të tilla si: diskriminimi me të drejtën për ajrim, për të takuar anëtarët e familjes, për të bërë telefonata, etj mohim i padrejtë i të drejtës për të marrë leje, korrupsion pasiv i administratës së institucionit në dhënien e lejes, masat disiplinore të padrejta. Për transferime të padrejta nga një institucion në tjetrin, dhe si rezultat i mosrespektimit të distancës duke e privuar nga e drejta për të takuar familjen kanë qenë 6 ankesa etj..

Operojnë edhe organizma ndërkombëtare të jashtëm që trajtojnë ankesat dhe këto organizma janë trajtuar gjërësisht tek pjesa me titull "Krijimi strukturave të pavarura të jashtme".

#### **IV. Gjetjet dhe problematika që lidhet me zbatimin praktik të mekanizmit të kërkesë-ankesës**

Ndërsa seksioni i mëparshëm fokusohet në legjislacionin aktual në fuqi dhe analizën e tij, të fokusuar posaçërisht në trajtimin e kërkesave dhe ankesave të personave të privuar nga liria në komisarate, paraburgime dhe burgje, ky seksion trajton aspektin praktik të funksionimit të mekanizmave të kërkesë-ankesës dhe realizimin e kësaj të drejtë në praktikë, duke nxjerrë në pah aspektet pozitive dhe negative të legjislacionit dhe sistemit aktual, si dhe gjetjet e evidentuara nga KShH. Kjo do të bëjë të mundur evidentimin e problemeve që ekzistojnë me qëllim dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës për një trajtim sa më human në përputhje me standardet e vendosura.

Funksioni kryesor i gati të gjitha organizmave të jashtme dhe të brendshme të mbikëqyrjes të vendeve të privimit të lirisë në Shqipëri ka qenë, ndër të tjera, trajtimi i kërkesave e ankesave, të cilat gjatë viteve, janë rritur në numër dhe, kanë ndikuar në evidentimin e mangësive të sistemit, si dhe në përmirësimin e tij. Kjo gjë ka bërë që të rritet gjithnjë e më tepër vëmendja ndaj trajtimit të problematikës që lidhet me mekanizmat e kërkesë-ankesës dhe nevojës për të studiuar sistemin aktual dhe për të dhënë rekomandime në përmirësimin e tij. Megjithatë, ka pasur pak

---

<sup>52</sup> Të dhëna të KShH-së për vitin 2011 deri në muajin Gusht.



hulumtime në studimin e efektivitetit të organeve të ndryshme në shqyrtimin e ankesave nga vendet e privimit të lirisë si dhe pak përpjekje për të përmirësuar sistemin dhe procedurat ekzistuese të kërkesë-ankesës.

#### **4.1. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar nga policia**

##### **4.1.1. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e shoqëruar nga policia**

Në raste të caktuara në ligj, policia bën shoqërimin e personit në ambientet e saj derisa çështja, për të cilën është kryer shoqërimi, verifikohet maksimalisht deri në 10 orë. Siç u përmend edhe në seksionin e mëparshëm, shoqërimi në polici bëhet për *‘mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; si dhe kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë’*<sup>53</sup>. Gjithashtu, sipas nenit 11 të Ligjit ‘Për policinë e shtetit’, pika 6, shoqërimi i personave mund të bëhet edhe *‘kur një person ka shkëlur një rregull administrative dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimit në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij’*.

Megjithëse neni 101 i ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për policinë e Shtetit” përcakton vetëm dy raste të shoqërimit në polici të personit, në vijim edhe neni 106 parashikon disa raste të tjera të shoqërimit. Kjo del nga interpretimi i dispozitës, konkretisht të nenit 101/4<sup>54</sup> dhe nenit 106 të Ligjit. Ky i fundit përcakton se masat mbrojtëse merren ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse. Në këto raste punonjësi i Policisë e shoqëron personin në mjediset e Policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit apo e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës<sup>55</sup>.

Pra ajo që konstatojmë është se në mënyrë të shpërndarë e madje edhe disi konfuze, në dispozita të ndryshme janë parashikuar 5 raste të shoqërimit të qytetarëve në ambientet e policisë. Kjo bën që edhe në kuptimin dhe zbatimin praktik të tyre të ketë probleme nga ana e punonjësve të policisë. Personat e shoqëruar kanë të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tyre<sup>56</sup>. Ata duhet të njoftohen menjëherë nga punonjësi i policisë për shkaqet e shoqërimit. Ajo çka vihet re nga vizitat monitoruese në ambientet e shoqërimit, rezulton se për shoqërimin dhe mbajtjen e personave në zyrat e policisë, punonjësi i policisë bën dokumentimin e veprimit në librin e personave të shoqëruar. Në të pasqyrohej identiteti i personit, datëlindja, arsyeja e shoqërimit, data dhe ora e hyrjes dhe daljes, emri i punonjësit të policisë që ka bërë shoqërimin, masat e marra, kërkesa për mjek nëse do të ishte e nevojshme apo për avokat, dhe njoftimi i familjes, si dhe shënime për pretendimet e të shoqëruarit. Kjo rubrikë e fundit vllente pikërisht për të pasqyruar kërkesat apo ankesat që mund të kishin personat e shoqëruar. Në librat e

<sup>53</sup> Neni 101/1 i Ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për policinë e Shtetit”

<sup>54</sup> Neni 101, përcakton:

“.....4. Për rastet e shoqërimeve për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimet ose ekstradimet, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjisllacionit në fuqi”.

<sup>55</sup> Neni 106/1 i Ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për policinë e Shtetit”

<sup>56</sup> Neni 101 i Ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për policinë e Shtetit”

shqyrtuar në komisariate të ndryshme, në këtë rubrikë nuk kishte asnjë shënim për ndonjë pretendim apo ankesë nga të shoqëruarit.

Nga vizitat, rezultoi se personat e shoqëruar mbahen në mjedise të ndryshme nga ato të personave të ndaluar ose të arrestuar. Për shoqërimet në polici, u informuam se personi njoftohet menjëherë për arsyet e shoqërimit, por atij i jepet mundësia për të njoftuar edhe një të afërm. Kur i shoqëruari është i mitur, atëherë në çdo rast u informuam se njoftohet menjëherë familja dhe për të miturit njoftohej gjithashtu edhe avokati dhe psikologu. Në Tiranë dhe Durrës ky detyrim realizohej në nivel drejtorie. Në lidhje me shoqërimin në polici, femrat dhe meshkujt shoqërohen në mjedise të veçuara nga njëri-tjetri dhe po ashtu të miturit shoqërohen në mjedise të veçanta nga ato të të rriturve. Në momentin e vizitave u evidentua vetëm një rast i një personi të shoqëruar në Komisariatin e Policisë Nr. 4 në Tiranë.

Ajo që u evidentua nga vizitat monitoruese është fakti se në Tiranë dhe Durrës, shoqërohen në ambientet e policisë një numër i konsiderueshëm personash për shkak të konflikteve të ndryshme me njëri-tjetrin, fyerjeve, goditjeve apo sherre mes tyre. Theksojmë se përveç qëllimit pozitiv që ka shoqërimi i personave në këto raste për parandalimin e ngjarjeve më të rënda, shoqërimi në këtë rast nuk ka bazë ligjore. Kjo për shkak se në radhët e policisë vazhdon të ekzistojë koncepti i shoqërimit sipas ligjit të mëparshëm të policisë së shtetit, kur shoqërimi bëhej edhe në raste të tilla, por që nuk mbështetet nga ligji aktual për policinë. Këto shoqërime të pabazuara në ligj mund të përbëjnë shkak për ankime nga ana e qytetarëve të shoqëruar, por shihet qartë që as punonjësit e policisë dhe as qytetarët në fjalë nuk janë në dijeni të këtyre procedurave të pabazuara në ligj.

Në çdo rast, të shoqëruarve iu bëhej kontrolli personal dhe iu hiqeshin sendet personale, si telefona, para, dokumente etj, por theksojmë se kjo procedurë nuk është në përputhje me ligjin. Kështu neni 106/3 i Ligjit për policinë e shtetit përcakton se punonjësi i policisë mund të bëjë kontrollin dhe këqyrjen fizike të personave të shoqëruar me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjithëse. Pra kontrolli fizik mund të bëhet vetëm në këto raste, dhe jo në çdo rast.

Po ashtu, neni 108 i këtij ligji parashikon se, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike. Prandaj, theksojmë se në këto raste të paautorizuara nga ligji, kontrolli i personave të shoqëruar përbën shkelje të hapur të së drejtës kushtetuese të paprekshmërisë personale të personit. Ky veprim nga ana e policisë vjen në kundërshtim me nenin 37/3 të Kushtetutës së RSH, ku përcaktohet se *“Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”*. Po ashtu, në rastet kur të shoqëruarve iu bllokohen sendet personale, nga vizitat monitoruese rezultoi se mbahej procesverbal, por kopje e dokumentit nuk i jepej edhe personit të shoqëruar.

Nga librat e shoqërimit nuk rezultoi që personat e shoqëruar të mbahen mbi afatin ligjor prej 10 orësh. Nuk ka dhoma shoqërimi të ndara për meshkujt, femrat dhe të miturit, sipas përcaktimit të nenit 107/3 të ligjit për policinë e shtetit. Vetëm në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë ka një dhomë për femra dhe një për të mitur. Në tërësi nga ambientet e vizituara, dhomat e shoqërimit

nuk plotësojnë kriteret dhe standardet për trajtimin human dhe dinjitoz të personave të shoqëruar. Kryesisht ato janë ambiente të mbyllura, të ngushta dhe pa hapësira, pa ndriçim të mjaftueshëm.

Në momentin e vizitës, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, ndonëse nuk kishte persona të shoqëruar në të tre dhomat e shoqërimit të kësaj drejtorie, ambienti linte për të dëshiruar, edhe për efekt të mungesës së higjienës dhe pastërtisë në këto ambiente. Në këtë drejtori, ndonëse na u bë me dije se të shoqëruarve iu njoftoheshin të drejtat e tyre, në ambientet e shoqërimit nuk kishte postera apo materiale të tjera ku evidentoheshin këto të drejta. E kundërta u evidentua në Tiranë, ku në komisarariat posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar dhe arrestuar, ishin vendosur në mënyrë të dukshme në ambientet e shoqërimit dhe të ndalimit/arrestimit. Madje në Tiranë, në ambientet e komisarariatit në vende të dukshme ishin të vendosura edhe urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm apo të drejtuesit të komisarariatit ë lidhje me të drejtat dhe detyrat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar si edhe detyrimet e stafit policor ndaj tyre (p.sh. kjo ishte e evidente në Komisarariatin e Policisë nr. 4).

Të gjitha këto mangësi të evidentuara gjatë monitorimeve, mund të përbëjnë arsye të ligjshme për personat e privuar nga liria që të bëjnë ankesat e tyre.

Inspektive në vendet e ndalimit/arrestimit apo shoqërimit janë kryer edhe nga inspektorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që kanë në fokus të kontrollit ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga stafi policor në fazën e arrestimit/ndalimit apo shoqërimit, kushtet dhe trajtimin e tyre gjatë kohës që qëndrojnë në këto ambiente si dhe respektimin e të drejtave të tyre gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2010, inspektimet ishin kryer edhe nga SHKB-ja në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, ku u evidentua se ndër të tjera objekt kontrolli nga ana e SHKB-së kishte qenë edhe libri i personave të shoqëruar. Ajo që vlen të theksohet si vërejtje është se gjetjet e këtyre raporteve të inspektiveve nuk bëhen publike, ndonëse mund të jenë objekt analize i punës së brendshme të institucionit.

Theksojmë gjithashtu, se në ligjin “Për policinë e Shtetit” nuk ka një dispozitë të veçantë që të parashikojë mundësinë e ankimimit të të shoqëruarve apo ndaluarve gjatë qëndrimit në polici për efekt shkeljesh të të drejtave të tyre. Kjo gjë është bërë vetëm pas daljes nga ky sistem.

#### **4.1.2. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e ndaluar/arrestuar nga policia**

Garancitë procedurale të personave të arrestuar/ndaluar përcaktohen nga Kodi i Procedurës Penale. Siç e përmendëm edhe më sipër, gjatë kohës që personi është i ndaluar/arrestuar, ndaj tij në asnjë rast nuk mund të ushtrohet dhunë apo çdo formë tjetër keqtrajtimi<sup>57</sup>. Personi ka të drejtën e mbrojtjes e cila duhet t’i garantohet në çdo fazë dhe gjendje të procedimit. Po ashtu KPP parashikon se në rast procedimi në kundërshtim me ligjin ose në rast dënimi të padrejtë, personit i kthehen të drejtat dhe shpërblehet për dëmin e pësuar<sup>58</sup>.

---

<sup>57</sup> Neni 5 i KPP.

<sup>58</sup> Neni 9 i KPP

Në lidhje me respektimin e të drejtave të personave që ndalohen/arrestohen apo shoqërohen nga policia marrin rëndësi të veçantë: e drejta për të pasur avokat, e drejta që atij t'i njoftohet arsyeja e ndalimit/arrestimit si dhe ky fakt t'i bëhet me dije familjarëve apo personave të tjerë përgjegjës/të interesuar, si dhe e drejta për të kërkuar ekzaminimin mjekësor.

Nga monitorimi rezulton se në komisariate mbahen disa lloj regjistrash/librash, si:

- Libri i takimeve me avokatin/Oficerin e Policisë Gjyqësore (OPGJ) apo prokurorin
- Libri i vizitave mjekësore
- Libri i kontrollit nga autoritetet kompetente në dhomat e shoqërimit, ndalimit/arrestimit
- Libri i të shoqëruarve
- Libri i lëvizjeve të të ndaluarve në gjykatë,
- Regjistri i të arrestuarve/ndaluarve me të dhënat respektive
- Regjistri i sendeve që u mbahen të arrestuarve/ndaluarve (për të shoqëruarit kjo gjë evidentohet në formë procesverbali në librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit nga stafi policor).

Në çdo rast, punonjësit e policisë duhet t'i bëjnë të ditur personit të ndaluar/arrestuar të drejtat e tij, gjë që, gjatë vizitave monitoruese, na u tha se bëhet në çdo rast nga ana e policisë. Gjithashtu, mbrojtësi duhet të ketë akses jo vetëm të kontaktojë në çdo kohë me të arrestuarin/ndaluarin, por të ketë akses në të dhënat e mbledhura si dhe të asistojë atë gjatë pyetjes, por edhe të garantohet në ambientet e policisë konfidencialiteti dhe privatësia e bisedës me klientin e tij. Në ambientet e monitoruara të komisariateve të Policisë në Tiranë e Durrës, ambientet aktuale nuk ofrojnë kushte dhe garanci reale për mbrojtjen e konfidencialitetit.

Në komisariate, ekziston edhe regjistri i takimeve me avokatin e të ndaluarit/arrestuarit, ku sipas rubrikave të këtij regjistri shënohet data, ora e hyrjes dhe daljes, emri i personit të arrestuar që ai përfaqëson, vërejtje (nëse ka) dhe firma e avokatit. Në të gjitha rastet e monitoruara, nuk rezultoi që të kishte ndonjë vërejtje nga avokati për ndonjë problem që lidhej me klientin e tij gjatë qëndrimit në komisariat. Ndërkohë rezultoi se nga këqyrja e dosjeve që mbahen nga policia në Komisaratin e Policisë Durrës, në të paktën një dosje të shqyrtuar u vërejtën parregullsi, pasi në deklaratimet para OPGJ, ndonëse ishte si rubrikë, nuk ishte plotësuar nga OPGJ në atë rast (nëse i arrestuari në flagrancë kishte avokat dhe nëse ishte përfaqësuar prej tij, nëse nuk kishte por donte një të tillë), duke e lënë këtë rubrikë të paplotësuar.

Theksojmë se në rastin në fjalë i arrestuari në flagrancë ishte një i mitur 17 vjeçar, gjë që përbën edhe shkelje procedurale të rëndë, po të kemi parasysh se ligji për të miturin, kërkon që mbrojtësi duhet domosdoshmërisht të jetë i pranishëm në çdo gjendje dhe fazë të procedimit.

Po ashtu, ambientet dhe kushtet e trajtimit në ambientet e policisë duhet të respektojnë parimet e trajtimit human në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare. Në fakt, në lidhje me ambientet fizike dhe infrastrukturën, dhomat e ndalimit/arrestimit nuk ofrojnë kushte për një trajtim të tillë. Për faktin se ato në një pjesë të rasteve janë të vjetra e të amortizuara, (shumica prej tyre datojnë si ambiente para viteve '90), ato nuk ofrojnë kushte të përshtatshme qëndrimi, ndriçimi, ajrimi për një trajtim të tillë human në përputhje me standardet. Po ashtu, pastërtia dhe kushtet higjeno-sanitare të ambienteve lenë për të dëshiruar. Këtyre u shtohet edhe fakti se në rastin e komisarariatit të policisë Durrës, lejohen të mbahen edhe ushqime në ambientet e të ndaluarve/arrestuarve. E ndryshme paraqitet situata në Komisarariatet e Policisë Tiranë, ku një

gjë e tillë është zgjidhur tashmë, përmes vakteve që ofrohen nga një firmë private, sipas një kontrate që ka DPPSH me këtë subjekt. Si praktikë e mirë, sugjerojmë që të shtrihet edhe në komisariatet e tjera.

Kushtet e papërshtatshme në komisariate, infrastruktura e vjetër dhe amortizuar, mungesa e fondeve dhe investimeve (apo edhe mospërdorimi i tyre siç duhet) janë ndër faktorët që gjithashtu kontribuojnë në mosplotësimin e standardeve për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar që mbahen në komisariatet e policisë dhe mund të përbëjnë shkak të ankimit nga individit i ndaluar/arrestuar. Megjithatë, nga këqyrja e regjistrave përkatës nuk u vu re asnjë ankesë lidhur me këto shkelje/shqetësime.

Në momentin e vizitës, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, na u bë me dije se të ndaluarve/arrestuarve iu njoftoheshin të drejtat e tyre. Në ambientet e kësaj drejtorie nuk kishte postera apo materiale të tjera ku evidentoheshin këto të drejta. E kundërta u evidentua në Tiranë, ku siç e përmendëm më lart, në komisariat posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar dhe arrestuar, ishin vendosur në mënyrë të dukshme në ambientet e ndalimit/arrestimit, në disa raste edhe në gjuhë të huaj. Po ashtu të afishuara ishin edhe urdhra të brendshëm të drejtuesve të policisë në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e këtyre personave. Për më tepër në Tiranë, në mjediset e komisariateve gjendej i ekspozuar edhe numri i Avokatit të Popullit 0800 1111 për të raportuar për shkelje apo keqtrajtim.

Nga çdo punonjës policie i pyetur për ushtrim dhune, si në Tiranë ashtu edhe në Durrës na u tha se në momentin e arrestimit/ndalimit apo edhe gjatë shoqërimit apo gjatë qëndrimit të personave në ambientet e policisë në komisariat, nuk ushtrohej dhunë apo ndonjë formë tjetër keqtrajtimi. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 64, dt. 25.01.2010, është miratuar 'Manuali për rregullat e trajtimit dhe sigurimin e të ndaluarve e të arrestuarve në njësinë policore'. Në të përcaktohen standardet dhe rregullat për trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, problemet e përmendura më sipër, tregojnë që këto rregulla e standarde nuk gjejnë ende zbatimin e duhur praktik në komisariate. Nga takimet dhe intervistat me punonjësit e policisë në komisariatet e vizituara dhe nga kontrolli i regjistrave, nuk rezultoi i dokumentuar se kishte ankesa nga ana e personave të ndaluar/arrestuar nga policia. Në lidhje me njoftimin e familjarëve, nga informacioni i dhënë prej stafit policor rezulton se njoftimi bëhej. Po ashtu edhe nga kontakti me persona të arrestuar të pyetur për këtë qëllim, rezultoi se familjarët ishin njoftuar por nuk lejohej kontakti me ta gjatë kësaj kohe.

Shenjat e gishtave merren në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe po aty bëhet edhe ekzaminimi nga mjeku dhe shihet gjendja shëndetësore e personit, duke lëshuar edhe kartelën përkatëse. Kur kanë probleme gjatë qëndrimit në komisariat, personat e arrestuar/ndaluar vizitohen/ekzaminohen nga mjeku, i cili vepron në nivel drejtorie.

Në Tiranë, dhomat për femrat dhe të mitur të arrestuar/ndaluar janë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe jo në komisariate të kësaj drejtorie, në kuadër të kushteve më të mira në nivel drejtorie për këto kategori.

Inspektime në vendet e ndalimit/arrestimit janë kryer nga inspektorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që kanë në fokus të kontrollit ligjshmërinë e veprimeve të

kryera nga stafi policor në fazën e arrestimit/ndalimit apo shoqërimit, kushtet dhe trajtimin e tyre gjatë kohës që qëndrojnë në këto ambiente si dhe respektimin e të drejtave të tyre gjatë kësaj periudhe. Kjo rezultoi se ishte kryer edhe nga SHKB-ja gjatë vitit 2010 dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, u evidentua se ndër të tjera objekt kontrolli nga ana e SHKB-së kishte qenë edhe libri i personave të ndaluar/arrestuar. Në përfundim të inspektimit, grupi harton një akt kontrolli në prani të personave të kontrolluar, duke bërë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e shkeljeve të konstatuara. Megjithatë, mendojmë se duhet të ketë modalitete dhe protokolle të posaçme se si do të kryhet kontrolli. Po ashtu, me rëndësi është edhe transparencja e inspektimeve, që në rast se është e përshtatshme, jo vetëm të lihen rekomandime në akt/kontrollin e hartuar me këtë rast, por, edhe të monitorohet situata nga strukturat kompetente për të parë nëse vërejtjet/rekomandimet janë reflektuar në kohë. Nga vizitat në komisariatet e policisë na u bë me dije se kryheshin inspektime të tilla, por nuk na u mundësua ndonjë kopje e gjetjeve/vërejtjeve të tyre.

Në përfundim mund të themi se përpos mangësive ligjore lidhur me garantimin e të drejtës së kërkesë-ankesës nga ana e individëve të shoqëruar/arrestuar/ndaluar, vizitat monitoruese nxorën në pah faktin se edhe në rastet e parregullsisë, shkeljeve dhe trajtimit jo të duhur nga ana e punonjësve të policisë, personat në konflikt me ligjin apo mbrojtësit e tyre nuk kishin ushtruar të drejtën e ankimit.

#### **4.1.3. Mekanizmi i kërkesë-ankesës për personat e privuar nga liria në paraburgime dhe burgje**

Për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tij, të paraburgosurit e të dënuarit i garantohet komunikimi me organet kompetente të trajtuar më lart tek pjesa e legjislacionit, ankimi në gjykatë dhe mbrojtja me avokat, si dhe adresimi i ankesave apo kërkesave tek OJF dhe organizma të tjerë vendas apo të huaj që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Nga pikëpamja formale ankesat mund të bëhen me gojë ose me shkrim. Në institucionin penal kërkesat/ankesat mbahen në një regjistër të veçantë. Madje ka edhe formate për adresimin e tyre p.sh. tek IEVP 'Ali Demi' Tiranë.

Sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, çdo i paraburgosur/ i dënuar ka të drejtë të informohet për rregullat e brendshme dhe disiplinore të institucionit si dhe për çdo akt që i jep atij mundësinë të njihet me të drejtat dhe detyrat si dhe me mënyrën e paraqitjes së kërkesave dhe ankesave. Këto të drejta dhe detyra ishin të vendosura edhe në ambiente të dukshme në burgje dhe paraburgimet e monitoruara.

Të paraburgosurve dhe dënuarve i krijohet mundësia që çdo ditë, me shkrim ose përjashtimisht në mënyrë verbale nëpërmjet personelit të institucionit, të paraqesin kërkesë, ankesë, ose të kërkojnë takim me drejtorin e institucionit apo personelin përgjegjës. Pasi këto kërkesa/ankesa mblidhen, regjistrohen në një libër të veçantë për kërkesë-ankesat që ka çdo institucion, ato i kalojnë drejtorit të institucionit, i cili i adreson tek personi përgjegjës i stafit të tij. Siç e përmendëm më sipër, për kërkesat dhe ankesat që i drejtohen institucionit, përgjigja duhet të jepet brenda 15 ditëve dhe në fakt nga librat e këqyrrur, rezulton se ky afat respektohet. Vlen të përmendim që edhe kur kërkesat/ankesat bëhen verbalisht, stafi i institucionit duhet t'i

dokumentojë ato në çdo rast në regjistrin përkatës dhe po ashtu t'i adresojë siç duhet. Institucionet kanë praktika të ndryshme për mënyrën sesi administrohen kërkesat dhe ankesat<sup>59</sup>

Në institucionet e monitoruara, kërkesë-ankesat lidhen me arsye si: takime shtesë me familjarët, telefonata shtesë apo në periudhën e pasdites, leje të veçanta dhe shpërblyese. Për dhënien e lejeve ndiqej një procedurë e përcaktuar shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Këto kërkesa merren dhe regjistroheshin më vete. I paraburgosuri apo i dënuari vihej në dijeni si në rastin e përgjigjes pozitive apo negative, si dhe për arsyet e refuzimit. Në rastin e kthimit të përgjigjes me shkrim për lejen, një kopje e vendimit i jepej të dënuarit. Në trajtimin e mekanizmit të kërkesë/ankesave ka rëndësi gjithashtu respektimi i parimit të konfidencialitetit, i cili theksohet edhe në aktet ndërkombëtare të tilla dhe që gjejnë pasqyrim edhe në legjislacionin tonë të brendshëm<sup>60</sup>. Kështu, të dënuarit/paraburgosurit kanë të drejtën që kërkesat apo ankesat e tyre t'ia parashtrijnë drejtpërdrejt dhe personalisht drejtorit të institucionit. Po ashtu këtë gjë mund ta bëjnë edhe me anëtarë të tjerë të stafit sipas llojit të kërkesë/ankesës<sup>61</sup>. Gjithsesi, duhet theksuar se rregullat procedurale për investigimin e ankesave përcaktohen në rregullore të brendshme të institucioneve (jo në ligj)<sup>62</sup>. Në rastin e kërkesave/ankesave të drejtuar brenda autoriteteve të institucionit, nga vëzhgimi rezultoi se konfidencialiteti nuk mund të garantohej për sa kohë që kërkesat/ankesat nuk ishin të futura në zarf apo të garantohej fshehtësia e korrespondencës në ndonjë mënyrë tjetër. Nga vizitat monitoruese rezultoi se ato mund të lexoheshin lirisht nga personeli që i mblidhte ato.

Për kërkesë-ankesat jashtë institucionit, ato mund të adresohen nëpërmjet shërbimit postar apo telefonit, duke garantuar në çdo rast konfidencialitetin dhe privatësinë e tyre. Për këtë qëllim në çdo institucion ka kuti postare, ku të dënuarit/paraburgosurit hedhin kërkesat/ankesat e tyre. Kutit postare janë vendosur në institucion nga Avokati i Popullit, ku edhe çelësat administrohen po ashtu nga personeli i këtij institucioni, gjë që përbën një garanci më shumë për respektimin në praktikë të së drejtës së kërkesë-ankesës.

Gjithashtu, për të adresuar kërkesë-ankesat e të paraburgosurve/të dënuarve, në IEVP e monitoruara ishin afishuar në ambiente të ndryshme brenda këtyre institucioneve numrat e telefonit të Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Nga kontaktet me stafin dhe të dënuarit rezultoi se përfaqësues të këtyre institucioneve kontaktonin edhe drejtpërdrejt personat që kishin bërë kërkesën/ankesën. Për kërkesë-ankesat e adresuara jashtë institucionit, një kopje e përgjigjes për dijeni i vinte edhe drejtorisë së institucionit. Kjo kryesisht për përgjigjet e ardhura nga Avokati i Popullit apo

---

<sup>59</sup> Në institucionin 'Ali Demi' Tiranë, kërkesat dhe ankesat hidheshin një një kuti të vendosur brenda regjimit, merreshin nga një punonjës që administronte postën jashtë dhe brenda regjimit dhe i dorëzonte kërkesë-ankesat në protokoll, ku regjistroheshin në një regjistër të veçantë dhe më pas trajtoheshin nga drejtuesi i institucionit, i cili i delegon ato tek punonjësit përkatës. Pasi trajtohet kërkesë-ankesa, i dënuari firmos për marrjen e përgjigjes në formatin përkatës. Në institucionet e tjera kërkesë-ankesat i mblidh punonjësi i kujdesit social i regjimit të brendshëm dhe pasi i regjistron në regjistrin e kërkesë-ankesave, ia kalon drejtuesit përkatës.

<sup>60</sup> Shih studimin "Assessing Prison complaints mechanism sin CEE and FSU regions", supported by Hungarian Helsinki Committee in cooperation with OSI Budapest, 2011, pg. 27.

<sup>61</sup> Po aty.

<sup>62</sup> Shih studimin "Assessing Prison complaints mechanism sin CEE and FSU regions", supported by Hungarian Helsinki Committee in cooperation with OSI Budapest, 2011, pg. 26.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve). Në institucionet e monitoruara, rezultoi se nuk ka pasur raste të ankesave që kërkesa/ankesa nuk është adresuar apo nuk është kthyer përgjigje.

Në institucionet penale, për personat e dënuar ka formularë për ulje dënimi apo lirim me kusht drejtuar gjykatës (rasti i IEVP' Ali Demi' Tiranë). Kur përgjigja vjen negative, rezultoi se këto kërkesa në një rast të tillë jo gjithmonë adresohen siç duhet; më së shumti për këto raste të dënuarit ankohen pranë Avokatit të Popullit por duhet ligjërisht t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Në institucionet penale, të privuarve nga liria u lejohej dy telefonata në javë dhe kur aprovohen kërkesat e tyre, edhe telefonata shtesë me familjarët apo të tjerë. Telefonatat regjistrohen në një regjistër të veçantë, ku vendoset emri i personit që telefon, numri të cilit ai i telefonon dhe kohëzgjatja e bisedës. Ndërsa biseda telefonike nuk dëgjohet nga ana e personelit, si garanci për konfidencialitetin e bisedës. Megjithatë, mendojmë se ky konfidencialitet nuk garantohet plotësisht, pasi distanca e personelit të institucionit me të dënuarin/paraburgosurin gjatë bisedës telefonike është shumë e afërt, gjë e cila bën që biseda praktikisht të dëgjohet.

Institucionet penale mundësojnë përmes mjediseve të posaçme takime konfidenciale të të dënuarve/paraburgosurve me anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës, Avokatin e Popullit dhe punonjësit e zyrës së tij, mbrojtësin, përfaqësues të OJF-ve, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut ose të organizmave ndërkombëtare.

#### **4.1.4. Kontrolli/monitorimi i brendshëm**

Aktualisht rezulton se ka një mekanizëm të brendshëm për kontrollin/monitorimin e respektimit të të drejtave të personave të dënuar/paraburgosur në institucionet penale, për të garantuar një trajtim sa më human të tyre në përputhje me standardet e vendosura për këtë qëllim. Inspektimi dhe mbikëqyrja e burgjeve kryhet nëpërmjet inspektorëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe inspektorëve të Sektorit të Inspektimit për Zbatimin e Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, gjë që u trajtua më sipër.

Ndërkohë theksojmë se në praktikë nuk funksionon veprimtaria e Komisionit Mbikëqyrës pranë MD si strukturë mbikëqyrëse e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet penale. Pavarësisht se ky komision parashikohet me ligj, personat e paraburgosur/të dënuar nuk e dinin ekzistencën dhe kompetencat e tij.

Edhe SHKB në institucionet penale kryen kontrole për shkelje nga ana e stafit me uniformë, por përveç sa më lart përmendëm, nuk disponojmë më tepër informacion në lidhje me punën e këtij shërbimi. Duhet theksuar që kjo strukturë duhet rishikuar për sa i takon mirëfunksionimit të saj, për t'i shërbyer më mirë misionit të zbatimit të ligjit nga ana e punonjësve të administratës së burgjeve.

Në përfundim, theksojmë se, me gjithë ekzistencën e strukturave të ndryshme të inspektimeve dhe mbikëqyrjes, ka nevojë për rishikimin e kompetencave dhe të protokolleve të këtyre inspektimeve, si dhe të cilësisë së këtij shërbimi.



#### **4.1.5. Kontrolli/monitorimi i jashtëm**

Në kuadrin e përmbushjes së rolit të tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, edhe Avokati i Popullit kryen inspektime në institucionet penale dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse në çdo rast. Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të privuar nga liria, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit. Për ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Popullit nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës, dhe siç e përmendëm mund të bëhen përmes postës, telefonatave apo drejtpërdrejt me anë të kontaktit me të dënuarin/paraburgosurin. Në çdo rast, garantohet konfidencialiteti. Në të gjitha rastet, Avokati i Popullit kthen përgjigje brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesë- kërkesës.

Duke pasur parasysh sa më sipër, Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve. Ky Mekanizëm monitoron rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgimit, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi johuman, çnjerëzor apo degradues; si dhe paraqet rekomandime përkatëse për organet përgjegjëse shtetërore, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e këtyre individëve.

Megjithatë, mbetet aktual shqetësimi për mbështetje të pamjaftueshme logjistike dhe financiare të kësaj strukture nga buxheti i shtetit, e cila ndikon drejtpërdrejt në mbetjen aktiv dhe eficient të kësaj strukture mbikëqyrëse.

Mbetet po ashtu, jo aktiv roli dhe pozicioni i prokurorit të ngarkuar me mbikëqyrjen në ekzekutimin e vendimeve penale, nisur nga kompetencat që ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i njeh në këtë drejtim (shih për më tepër trajtimin në kreun përkatës).

#### **4.1.5/a Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare**

Në institucionet e privimit të lirisë, monitorimi mund të kryhet edhe nga OJF lidhur me rregullsinë e ekzekutimit të vendimit dhe respektimin e të drejtave të të dënuarit/paraburgosurit, duke rekomanduar marrjen e masave konkrete dhe kur e shohin me vend, të kërkojnë ndërhyrjen e instancave përkatëse. Monitorimi në këto institucione bëhet në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke respektuar, në çdo rast, privatësinë dhe konfidencialitetin e të dhënave. Hyrja në këto institucione e organizatave që monitorojnë respektimin e të drejtave të të dënuarve apo paraburgosurve bëhet në përputhje me Ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve" dhe me nenin 66 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Ligji dhe më tej Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka një dispozitë të veçantë për aksesin e OJF-ve në institucionet e mbyllura. Kërkohet të paraqitet një kërkesë me shkrim drejtuar drejtorit të institucionit ku të paraqitet objekti dhe detajet e vizitës dhe drejtori i institucionit e shqyrton brenda pesë ditësh kërkesën për hyrje dhe duhet të japë përgjigje me

shkrim për lejimin ose mos lejimin duke shpjeguar arsyen e moslejimit në rast përgjigje negative. OJF-të kanë të drejtë apelimi tek Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Në vitin 2011, janë penguar në ndonjë rast vëzhguesit e KSHH-së për arsye të mungesës së një marrëveshje formale mes KSHH-së dhe DPB-së, ndërkohë që ligji është akt ligjor, e si i tillë, prevalon mbi marrëveshjet.

Sa i takon monitorimit në ambientet e komisariateve të policisë, në çdo rast kërkesa i duhet drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me detajet e emrave, numrin e pasaportës dhe objektin e hyrjes në komisariate dhe kohëzgjatjen e vëzhgimit. Duhet te theksojmë nevojën e një shtese në ligj e rregullore për një dispozitë të veçante për lehtësimin e aksesit në këto institucione të OJF-ve të cilat e kanë në statutin e tyre veprimtarinë monitoruese në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe të drejtat e personave të privuar nga liria.

Për aksesin e organizatave ndërkombëtare në paraburgime /burgje është folur gjerësisht me parë në këtë studim.

## **V. Sugjerime**

### **5.1. Për përmirësimin e bazës ligjore**

- Sugjerojmë që të merren masa të menjëhershme për hartimin e bazës ligjore dhe nënligjore, për të bërë të mundur garantimin e ushtrimit të një nga të drejtave themelore të shtetasve që shoqërohen/ndalohen/arrestohen siç është ajo e kërkesë-ankesës, në komisaritet e policisë.
- Përveç personave të privuar nga liria, legjislacioni vendas duhet të garantojë se edhe mbrojtësit ligjorë, familjarët e personave të privuar nga liria, si edhe çdo njeri tjetër që ka dijeni për rastin, duhet të kenë të drejtën e bërjes së një ankese në interes të personit në fjalë; gjithashtu, legjislacioni duhet të garantojë të drejtën e bërjes së ankësës edhe OJF-ve të cilat përfaqësojnë interesat e personit të privuar nga liria, sigurisht me pëlqimin e këtij të fundit;
- Legjislacioni i fushës duhet të parashikojë të drejtën e pezullimit të zbatimit të një vendimi/mase disiplinore ndaj personave të privuar nga liria kur objekt i ankësës është vendimi/masa në fjalë;
- Pavarësisht se legjislacioni shqiptar në përgjithësi, garanton të drejtën e mbrojtjes ligjore falas të personave të privuar nga liria, sugjerojmë që legjislacioni që lidhet me procedurën e kërkesë-ankesës, të garantojë gjithashtu, të drejtën që personat e privuar nga liria duhet të kenë për t'u përfaqësuar nga mbrojtësit e tyre ligjorë, ose nga organizata të cilat ofrojnë ndihmë ligjore falas, gjatë procesit të brendshëm të bërjes dhe trajtimit të kërkesë-ankesës.
- Legjislacioni vendas në këtë fushë nuk parashikon në mënyrë të qartë procedurat e ankimit që personat e privuar nga liria duhet të ndjekin, në rastet kur dëshirojnë të ankimojnë vendimet e marra nga autoritetet shtetërore për ankesat e tyre. Për më tepër, ligji duhet të jetë i qartë për garantimin e aksesit tek një autoritet shtetëror i pavarur për rishikimin e vendimeve të marra në lidhje me ankesat e trajtuara.

## 5.2 Për përmirësimin e zbatimit të ligjit

Duke pasur parasysh se në ligjin për policinë e shtetit nuk parashikohen dispozita të veçanta për realizimin e ushtrimit të kërkesë – ankesës, kjo pjesë e rekomandimeve është fokusuar tek zbatimi i bazës ligjore në sistemin e burgjeve. Me ngritjen e bazës së plotë ligjore dhe nënligjore për sistemin e policisë, patjetër do të dalë nevoja e marrjes së masave konkrete për zbatimin e ligjit në këtë drejtim.

Kështu për sistemin e burgjeve paraqesim si më poshtë:

- Megjithëse ka praktika të ndryshme të administrimit të kërkesë-ankesës në institucione të ndryshme penale të sistemit të burgjeve, sugjerohet të hartohet një protokoll i shkruar dhe i unifikuar, ku të përcaktohen qartë procedurat e administrimit të kërkesë-ankesës, personat përgjegjës, procedurat dhe afatet kohore të kthimit të përgjigjes;
- Hartimi i procedurave/protokollit të shkruar për kërkesë-ankesën do të krijojë mundësinë e garantimit të konfidencialitetit, që në momentin e bërjes së një ankese dhe gjatë procesit të shqyrtimit të saj. Në këtë drejtim, sugjerohet të merren masa konkrete dhe praktike që konfidencialiteti të garantohet plotësisht gjatë shqyrtimit të ankesave, sidomos brenda sistemit të burgjeve;
- Është i nevojshëm hartimi i një formati standard të kërkesës dhe ankesës për personat e privuar nga liria në të gjitha institucionet penale, i cili do t'i vijë në ndihmë personave të privuar nga liria, për lehtësimin e procesit të paraqitjes së kërkesë-ankesave të tyre. Gjithsesi, bërja e kërkesë-ankesës në forma dhe mënyra të tjera, ka sërish të njëjtën vlerë administrative dhe juridike;
- Duke qenë se ka kuptueshmëri të ndryshme të koncepteve të kërkesë ankesës në institucionet penale dhe të policisë së shtetit, sugjerohet të realizohen veprimtari të ngritjes së profesionalizmit të personelit të këtyre institucioneve në lidhje me konceptet e kërkesë ankesës dhe procedurat e zbatimit të ligjit në këtë drejtim.

## 5.3 Rritja e efijencës së strukturave mbikëqyrëse/inspektuese/monitoruese të brendshme/të jashtme

- Duke qenë se në praktikën shqiptare ekzistojnë një sërë strukturash të brendshme të cilat kanë kompetencën e inspektimeve dhe mbikëqyrjes, duhet analizuar efijenca e tyre, sa të afta janë ato të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, si edhe sesa transparente janë procedurat e ndjekura prej tyre. Për më tepër, pjesë e analizës duhet të jetë edhe fakti sesa të efektshme janë veprimtaritë e tyre inspektuese dhe mbikëqyrëse për sistemin e policisë dhe të burgjeve dhe sesa impakt kanë ato për përmirësimin e situatës në këtë drejtim.
- Duke pasur parasysh praktikat e mira të disa prej vendeve evropiane, që na sjell në vëmendje ky studim, sistemi shqiptar i policisë dhe ai i burgjeve, duhet të përshtatë një nga këto modele, që të garantojë struktura të brendshme inspektimi transparente, efijente, si dhe struktura mbikëqyrëse, të cilat, krahas performacës së personelit të tyre, të kenë objekt shqyrtimi respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, përfshirë këtu edhe marrjen e ankesave.

- Tërheqim vëmendjen se, megjithëse ligji parashikon funksionimin e Komisionit Mbikëqyrës për Ekzekutimin e Vendimeve Penale, në praktikë ky komision nuk funksionon. Ndaj dhe sugjerohet të merren masa për ta bërë këtë strukturë efiçente duke iu referuar edhe praktikave të mira evropiane.
- Pjesë e kësaj analize duhet të jenë edhe niveli profesional i personelit që punon në këto struktura të brendshme, metodologjia e punës së tyre, burimet e tyre financiare dhe logjistike.
- Del e nevojshme rishikimi i procedurave me shkrim dhe protokolleve të strukturave që kanë kompetencë inspektimin dhe mbikëqyrjen, në mënyrë që ato të reflektojnë standardet e inspektimit dhe transparencën e këtyre veprimtarive.
- Për sa i takon institucioneve të pavarura të jashtme të monitorimit siç janë Avokati i Popullit me Njësinë për Parandalimin e Torturës, sugjerojmë që këto struktura të kenë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe logjistike për të bërë të mundur funksionimin e tyre normal.

### **Bibliografia**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998).
- Rregullat e OKB për Mbrojtjen e Fëmijëve të Privuar nga Liria (Rregullat e Havanës), 1990
- Grupi i Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave që i nënshtrohen çdo forme burgimi apo paraburgimi, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, dhjetor 1988.
- Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rec (2006) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës
- D. van Zylsmit – S. Snachen: Parimet e së Drejtës Evropiane të Burgjeve dhe Politikat, Oxford: Oxford University Press, 2009.
- “Ankesat – Vlerësimi i Mekanizmave të ankesën në burgje në Evropën Lindore Qendrore” – Komiteti Hungarez i Helsinkit, 2010.
- Rregullat Standarde Minimale të OKB për trajtimin e personave të privuar nga liria, 1957.
- Protokollin opsional i OKB i Konventës kundër Torturës dhe trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose poshtëruese (OPCAT, 2002).
- "Parimet lidhur me Statusin e Institucioneve Kombëtare", (Parimet e Parisit), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, 1993.
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), OKB, 1966.
- Konventa e OKB kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera, Çnjerëzore ose Poshtërues, 1984.
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe/ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, 1987.

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Strasburg, 1950.
- Ligji nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për policinë e Shtetit”.
- Ligji nr. 8328, dt. 16.04. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. .8331, dt. 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.
- Ligji Nr 7895, dt 21.01.1995, ” Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë “, i ndryshuar
- Ligji Nr 7905, dt 21.03.1995, “ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë “, i ndryshuar.
- “*Assessing Prison complaints mechanism sin CEE and FSU regions*”, studim i mbështetur nga Hungarian Helsinki Committee in cooperation ëith OSI Budapest, 2011.
- Ligji nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
- Ligji nr 9397 dt 12.05.2007, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm ne Sistemin e Burgjeve”.
- Ligji Nr 8677, dt 02.11.2000, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë Gjyqësore“.
- VKM nr. 303 datë 25.03.2009, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, e ndryshuar.
- Të dhëna të KSHH për vitin 2010.
- Të dhëna prezantuar nga përfaqësues të Avokatit të Popullit në Konferencën Kombëtare *Mbi hapjen e vendeve të privimit të lirisë ndaj monitoruesve – ‘Arritjet në shërbimet parandaluese dhe rehabilitim – praktikat më të mira dhe angazhimet e përbashkëta’*, organizuar nga Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Viktimave të Traumës dhe Torturës, Tiranë, prill 2011.
- Të dhëna të Avokatit të Popullit, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

## ANEKS 1

Lista e personave te kontaktuar në institucionet e vizituara

- Z. Iljaz Labi, Zv/drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve
- Znj. Irena çela, Drejtore e IEVP “Ali Demi”, Tiranë
- Znj. Xhizela Haxhiu, punonjëse sociale, IEVP “Ali Demi”, Tiranë
- Znj. Drivalda Hoxha, psikologe, IEVP “Ali Demi”, Tiranë
- Z. Fetah Dyrmishi, Përgjegjës i dhomave të shoqërimit/ndalimit/arrestimit, Komisarjati Policisë Nr. 4, Tiranë
- Z. Patriot Çobaj, Shef i sektorit juridik, Institucioni i Paraburgimit 302, Tiranë
- Z. Abdullah Duka, Drejtor i Institucionit të Paraburgimit, Durrës
- Z. Rezart Tusha, Zv/Drejtor i Institucionit të Paraburgimit, Durrës
- Znj. Ina Domi, Shefe e sektorit të kujdesit social, Institucioni i Paraburgimit, Durrës
- Z. Karafil Xholi, Shef i Rendit dhe Sigurisë Publike, Drejtorja e Policisë e Qarkut Durrës

## ANEKS 2

- Të dhëna statistikore
- *Të dhëna statistikore marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*


### Kërkesa-ankesa nga të paraburgosurit/ të dënuarit

Viti	2007	2008	2009	2010
Numri i kërkesave-ankesave	1.984	2.666	1.751	1.776

- *Të dhëna statistikore të institucioneve të monitoruara për periudhën Janar-Mars 2011*

Institucioni	Të dënuar	Të paraburgosur	Të arrestuar/ndaluar/shoqëruar	Kërkesë (janar-mars 2011)
IEVP, Durrës	4	252	-	115 kërkesa
IEVP, “M. Peza”	8	196	-	265 kërkesa
IEVP, “A. Demi”	171	-	-	688 kërkesa
Komisariati Policisë, nr. 4, Tiranë	-	-	1	-
Drejtoria e Policisë, Qarku Durrës	-	-	3	2 kërkesa

## Të dhëna statistikore të krahasuara



Të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme tregojnë numrin e kërkesë – ankesave të bëra nga të paraburgosurit/të dënuarit gjatë periudhës Janar - Gusht 2011 ardhur në adresë të Komiteti Shqiptar të Helsinkit (KShH), Avokatit të Popullit (AP), si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB).